BASHKIA
ELBASAN

ROMACTED

*Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimit Rom në nivelin vendor*

# PLANI VENDOR PËR INTEGRIMIN E PAKICAVE ROME DHE EGJIPTIANE 2019-2022

## Bashkia Elbasan




Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

IRCA – Institute of Romani Culture in Albania

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës

EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës

BASHKIA
ELBASAN

ROMACTED
Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimit Rom në nivelin vendor

# PLANI VENDOR PËR INTEGRIMIN E PAKICAVE ROME DHE EGJIPTIANE 2019-2022

## BASHKIA ELBASAN

**Programi ROMACTED**

Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimit Rom në nivel vendor

**Një program i përbashkët i**
**Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës**

**Koordinator Vendor, Bashkia Elbasan:**
Shefki Lika, Drejtor i Shërbimeve të Kujdesit Social dhe Komunitar

**Ekspertë**:
Elona Dhembo
Mirsa Titka
Raimonda Duka
Raxhi Rakipi
Xhesika Korra

**Redaktor:**
Orsiola Kurti

Ky dokument është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.

Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës.

Të gjitha palët që janë të interesuara për ta riprodhuar apo përkthyer të plotë apo pjesërisht këtë dokument, inkurajohen ta bëjnë diçka të tillë me autorizimin paraprak të Programit ROMACTED (romacted@coe.int).

Dizajni dhe printimi:  Gent Grafik

Publikuar prej Programit ROMACTED
Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë
Sheshi Skënderbej, Pallati i Kulturës
Kati i tretë, Tiranë, Shqipëri
www.coe-romacted.org

www.coe.al
www.ec.europa.eu

© Programi ROMACTED, Dhjetor 2020



# Falënderime

Dëshiroj të falënderoj të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e hartimit të Planit Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022 të Bashkisë Elbasan.

Përmes këtij dokumenti vendor, Bashkia Elbasan tashmë gëzon një pasqyrë të analizës situacionale të problematikave kryesore të pakicave rome dhe egjiptiane në bashkinë tonë, por edhe të masave të dakordësuara midis përfaqësuesve vendorë bashkiakë, institucioneve të tjera, organizatave të shoqërisë civile rome dhe egjiptiane dhe anëtarëve të Grupit Komunitar të Veprimit.

Shpreh sigurinë që zhvillimi në bashkinë tonë mund të jetë i qëndrueshëm vetëm përmes ndjekjes së një strategjie gjithëpërfshirëse si parashikuar në këtë plan. Pjesëmarrja e vetë komuniteteve rrit vlerën e këtij produkti gjithashtu. Në drejtim të institucionit të Bashkisë Elbasan shpreh gatishmërinë institucionale në lidhje me transformimin e masave në projekte konkrete vendore në përfitim të pakicave rome dhe egjiptiane në Elbasan.

Falënderime për të gjithë kontribuesit dhe mbështetjen e ofruar prej Programit të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "ROMACTED: Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimit Rom në nivelin vendor".

Me respekt,

**Gledian LLATJA**

Kryetar i Bashkisë Elbasan

## Shkurtime

| | |
|---|---|
| AFP | Arsimi dhe Formimi Profesional |
| ASPA | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike |
| BE | Bashkimi Evropian |
| DAP | Departamenti i Administratës Publike |
| DAR | Drejtoria Arsimore Rajonale |
| DRAFP | Drejtoria Rajonale e Arsimit e Formimit Profesional |
| DRAKPA | Drejtoria Rajonale e Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësisë. |
| DSHS | Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar |
| GIP | Grupi Institucional i Punës |
| GKV | Grupi Komunitar i Veprimit |
| IRCA | Instituti i Kulturës Rome |
| KiE | Këshilli i Evropës |
| MASR | Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| MSHMS | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale |
| NAPIRE | Plani Kombëtar për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve |
| NE | Ndihma Ekonomike |
| NJA | Njësi Admnistrative |
| NJMF | Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve |
| NJQV | Njësi të Qeverisjes Vendore |
| NJVKSHE | Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Elbasan |
| PAK | Persona me Aftësi Ndryshe (të kufizuar) |
| PV | Plan Veprimi |
| PPV | Plan i Përgjithshëm Vendor |
| RAT | Reforma Territoriale Administrative |
| SKZHI | Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim |
| SHKP | Shërbimi Kombëtar i Punësimit |
| ZA | Zyra Arsimore |

# Pasqyra e Lëndës


| | | |
|---|---|---|
| **FALËNDERIME** | | **5** |
| **I.** | **HYRJE** | **9** |
| **II.** | **KUADRI LIGJOR DHE POLITIK** | **11** |
| **III.** | **METODOLOGJIA ROMACTED, PROCESI DHE AKTORËT E PËRFSHIRË** | **14** |
| **IV.** | **ANALIZA SITUACIONALE VENDORE** | **18** |
| **V.** | **METODOLOGJIA ROMACTED, PROCESI DHE AKTORËT E PËRFSHIRË** | **22** |
| | V.1 ARSIMI | 26 |
| | V.2 SHËNDETËSIA | 28 |
| | V.3 PUNËSIMI | 28 |
| | V.4 MBROJTJA SOCIALE | 30 |
| | V.5 QENDRA KOMUNITARE | 32 |
| | V.6 STREHIMI DHE INFRASTRUKTURA URBANE | 32 |
| | V.7 REGJISTRIMI CIVIL | 34 |
| **VI.** | **VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E PLANIT VENDOR** | **36** |
| **VII.** | **PLANI I MASAVE** | **38** |
| **VIII.** | **BURIME FINANCIARE** | **70** |
| **IX.** | **MONITORIMI DHE VLERËSIMI** | **74** |
| **X.** | **SHTOJCA** | **77** |
| | X.1 VLERËSIMI I KAPACITETEVE TË BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE TË TJERA NË NIVEL VENDOR PËR BASHKINË ELBASAN | 77 |
| | X.2 GRUPI I TASK FORCËS BASHKIAKE NË ELBASAN | 83 |
| | X.3 VENDIMI I KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN | 85 |

# I. Hyrje

Reforma e decentralizimit dhe qeverisjes vendore dhe reforma territoriale administrative shtroi sfida të reja për bashkitë e reja në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm dhe qeverisjes së mirë. Një nga sfidat është përmirësimi i menaxhimit të të gjitha burimeve vendore për një zhvillim ekonomik dhe social të qëndrueshem. Gjithashtu me rëndësi të veçantë janë edhe forcimi i planifikimit strategjik, forcimi i kapaciteteve administrative dhe profesionale të administratës vendore, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve, rritja e pjesëmarrjes qytetare ( e të gjitha komuniteteve) në proceset e vendim-marrjes vendore si dhe monitorimi i zbatimit të politikave dhe programeve në nivel vendor mbi bazën e parimit të mos-diskriminimit dhe angazhimit qytetar.

Qeverisja vendore është rezultat i ndërveprimeve, marrëdhënieve midis sektorëve dhe aktorëve të ndryshëm (sektori publik, sektori privat dhe shoqëria civile) dhe përfshin vendime, negociata dhe marrëdhënie fuqie të ndryshme midis palëve të interesuara për të vendosur kush bën çfarë, kur dhe si planifikohen, menaxhohen dhe rregullohen shërbimet brenda një sistemi politik dhe social[1]. Qeverisja e mirë përfshin kapacitetin e qeverisjes për të menaxhuar me efikasitet burimet e veta dhe për të zbatuar politika të përshtatshme, si dhe ekzistencën e një kontrolli demokratik mbi agjentët e ngarkuar nga autoriteti[2].

Planet vendore të zhvillimit janë një instrument zhvillimi për bashkitë për të përmirësuar aspekte të qeverisjes vendore në kuadër të zbatimit të politikave të zhvillimit, bazuar në vlerësimin e nevojave, mundëson shpërndarjen e prioritizuar të burimeve të vlefshme, lejon identifikimin e hendekut financiar për të negociuar me aktorë të tjerë dhe agjenci donatore në mbështetje të projekteve të zhvillimit në nivel vendor, si dhe mundëson monitorimin e rregullt të zbatimit të masave dhe aktiviteteve.

Plani Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane për Bashkinë Elbasan është një zhvillim progresiv i Planit Kombëtar për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, si dhe Planit për Mbrojtjen Sociale 2017-2022 të miratuar nga Bashkia Elbasan, i cili synon zbatimin e masave për lehtësimin e integrimit të komunitetit, si dhe zhvillimin progresiv të tij, në vijim të angazhimit politik të Kryetarit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak dhe në frymën e bashkëpunimit me projektin ROMACTED[3]. Gjithashtu, mbrojtja e të drejtave të njeriut përfshirë

1 Udhëzues për të matur Qeverisjen Vendore
2 Qeverisja e mirë (Banka Botërore)
3 Në këtë kuadër është nënshkruar edhe një memorandum mirëkuptimi midis palëve.

agjendën rome dhe politikat jodiskriminuese është një nga pesë prioritetet e agjendës së integrimit evropian të Shqipërisë, që përfshin "masa efikase për forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, duke përfshirë romët dhe politikat antidiskriminuese"[4].

Principet kryesore të Planit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në nivel vendor udhëhiqen nga: (i) nxitja e përfshirjes sociale (ii) reagim ndaj situatave të vështira social-ekonomike dhe emergjente për pakicat rome dhe egjiptiane, (iii) respektimit të dallimeve midis pakicave rome dhe egjiptiane, (iv) përfshirjen e komuniteteve në identifikimin e nevojave dhe hartimin e masave (v) forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit midis aktorëve: bashkisë dhe institucioneve qendrore, organizatave të shoqërise civile, aktivistëve dhe grupeve komunitare.

Masat e Planit Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane për Bashkinë Elbasan janë grupuar në 6 fusha prioritare: regjistrimi civil, arsimi, punësimi dhe zhvillimi i aftësive, shëndetësia, strehimi dhe integrimi urban, dhe mbrojtja sociale.

4 Bashkimi Evropian, Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2013-2014http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/strategy_paper_2013_en.pdf, f. 19.

# II. Kuadri ligjor dhe politik

Në Shqipëri, kuadri ligjor që garanton respektimin e të drejtave të pakicave është i mirë zhvilluar duke filluar me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, për të vazhduar me konventat ndërkombëtare dhe ligje, ku ndër të tjera përfshihen: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (Kombet e Bashkuara, 1948[5]), Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (1966), të ratifikuar në vitin 1991, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, 1976 (1991), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës dhe Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare[6], Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, 1980 (1996), Konventa për Nxitjen e Punësimit dhe Mbrojtjen nga Papunësia (nr.168 të ILO-s), 1988 (2006), Konventa kundër Diskriminimit në Arsim (1960), Konventa për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual (ligji nr. 10071/2009), etj.

Me miratimin dhe ratifikimin e konventave ndërkombëtare, pas viteve '90 qeveritë shqiptare kanë hartuar dhe miratuar ligje (dhe akte nën-ligjore) si dhe politika të tjera[7], të cilat kanë krijuar premisat për një mjedis më mundësues për integrimin e pakicave në vend. Nga ana tjetër, edhe procesi i integrimit evropian përfaqëson jo vetëm një mundësi për vendin, por edhe një sfidë për sa i përket realizimit të reformave strukturore drejt statusit shtet anëtar i Bashkimit Evropian, duke ndikuar në shtyrjen përpara edhe të proceseve integruese për pakicat.

**Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim** (SKZHI) 2015-2020 dhe politikat sektoriale Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA), Strategjia për Mbrojtjen Sociale janë fokusuar në (i) *përmirësimin e përfshirjes sociale dhe aksesit në shërbimet bazë* për personat dhe grupet e margjinalizuara, (ii) *ofrimin e programeve të specializuara, që lehtësojnë aksesin në tregun* e punës

5 Miratuar në vitin 1955
6 Ligji Nr. 8496 / 1999
7 Ligje specifike të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt apo indirekt përfshijnë: ligji "Për avokatin e popullit" (8454/1999), ligji "Për mbrojtjen e të dhënave personale" (9887/2008), ligji "Për barazinë gjinore" (9970/2008), Kodi zgjedhor (2008), ligji "Për ndihmën juridike" (10039/2008), ligji "Për mbrojtjen nga të gjitha format e diskriminimit" (2010), ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e minoriteteve", i ndryshuar (Ligji Nr. 96/2017), VKM-ja "Për arsimimin e komuniteteve minoritare në gjuhën e tyre amtare", i ndryshuar, ligji për strehimin social (Ligji nr.22/2018), etj. Po kështu një sërë vendimesh të KM dhe dokumentesh politikë në këtë kuadër përfshijnë: Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) "Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Komitetit Shtetëror për Minoritetet", i ndryshuar (VKM 726/12 Dhjetor 2018), Plani Kombëtar për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit, i ndryshuar, Strategjia kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit rom, Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) dhe Dekada e Përfshirjes së Romëve, 2010 – 2015, PKV për Integrimin e Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, 2016-2020.

dhe rrisin mundësitë e punësimit, (iii) *ofrimin e mundësive për ndjekjen e arsimit të detyrueshëm dhe të mesëm* për personat, që kanë kaluar moshën e arsimit të detyrueshëm dhe që nuk e kanë përfunduar atë, (iv) *Shtrirja e shërbimeve psiko*logjike, veçanërisht në shkollat ku ka fëmijë romë dhe egjiptianë dhe nxënës, që rrezikojnë të braktisin shkollën, (v) *Lehtësimi i aksesit të grupeve vulnerabël në shërbimet shëndetësore* përmes sigurimit të shërbimeve të shëndetit publik, ofrimi i kujdesit shëndetësor specifik dhe i paketave të informacionit, si dhe i programeve specifike për aksesin në sistemin shëndetësor, ofrimi i mbështetjes nga punonjësit socialë dhe shërbimet e duhura shëndetësore, (vi) *Krijimi i sistemeve të integruara të shërbimit në nivel rajonal/vendor,* sipas standardeve të kujdesit për të gjitha grupet vulnerabël nëpërmjet përmirësimit të mekanizmave kombëtarë dhe vendorë për identifikimin dhe vlerësimin e nevojës për shërbimet e kujdesit social në përputhje me procedurat standarde të veprimit dhe harmonizimin e legjislacionit shqiptar me kërkesat ndërkombëtare.

Masat e Planit Kombëtar të Veprimit (PKV) për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve (2016-2020) janë projektuar në gjashtë fusha prioritare: regjistrimi civil, arsimi dhe dialogu ndërkulturor, punësimi dhe zhvillimi i aftësive, kujdesi shëndetësor, strehimi dhe integrimi urban, si dhe mbrojtja sociale. Mbrojtja e të drejtave të njeriut duke përfshirë romët dhe politikat antidiskriminuese është një nga pesë prioritetet kyçe të agjendës për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Parimet kryesore të PKV-së për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve janë elemente si: (i) nxitja e përfshirjes sociale, (ii) masat për përgjigjen ndaj situatave të emergjencës, (iii) respektimi i dallimeve midis dhe brenda këtyre komuniteteve, (iv) garantimi i përfshirjes së këtyre komuniteteve në projektimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave publike, (v) nxitja e bashkëpunimit midis aktorëve (qeverisja qendrore dhe njësitë e qeverisjes vendore, OSHC-të dhe komunitetet).

Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (2015-2020), Reforma Territoriale Administrative (2015), Ligji për vetëqeverisjen vendore[8], Ligji për financat publike vendore[9] krijuan bazën dhe hapësirën për reformimin e mëtejshëm të njësive të qeverisjes vendore dhe riorganizimin administrativ të bashkive mbi bazën e ndarjes së re territorale. Synimet strategjike janë të lidhur me: (i) rritjen e efiçiencës së strukturave të qeverisjes vendore, (ii) forcimin e financave vendore dhe decentralizimin fiskal, (iii) zhvillimin ekonomik vendor të qëndrueshëm dhe (iv) qeverisjen e mirë në nivel vendor. Ligje të tjera të rëndësishme janë edhe Ligji 119/2014 Për të Drejtën e Informimit dhe

8 Ligji 139/2015 Për Vetëqeverisjen Vendore
9 Ligji 68/2017 Për Financat Vendore

Ligji 146/2014 Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik. Me transferimin e disa funksioneve nga qeveria në NJQV në vitin 2016, janë rritur kompetencat e bashkive lidhur me funksionin e përfshirjes sociale[10].

Në Shqipëri, Qeverisja e Mirë ka të bëjë me zhvillimin e përgjegjshëm të çështjeve publike dhe menaxhimin e burimeve publike të cilat janë përfshirë në 12 Parimet e Qeverisjes së Mirë[11] të Këshillit të Evropës. Këto 12 parime janë të përfshira në Strategjinë për Inovacionin dhe Qeverisjen e Mirë, miratuar me vendim të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në vitin 2008. Ato mbulojnë çështje të tilla si sjellja etike, sundimi i ligjit, efikasiteti dhe efektiviteti, transparenca, menaxhimi i shëndoshë financiar dhe llogaridhënia.

Në Shqipëri, aktivitetet e Këshillit të Evropes[12] përqendrohen kryesisht në trajtimin e pengesave që mbajnë në vend të drejtat e pakicave, pavarësisht ecurisë në raport me angazhimet ligjore. Synimi i Këshillit të Evropës[13] në lidhje me mbrojtjen e pakicave kombëtare është arritja e një uniteti më të madh ndërmjet anëtarëve të tij, me qëllim realizimin e parimeve dhe idealeve që përbëjnë trashëgiminë e tyre të përbashkët duke gjykuar se një prej metodave për arritjen e këtij qëllimi është ruajtja dhe realizimi i mëtejshem i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Bazuar në këto konsiderata, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës ka miratuar «Deklaratën e Strasburgut"[14] e cila ka për qëllim fuqizimin dhe promovimin e pjesëmarrjes efektive të pakicave rome në jetën shoqërore, politike dhe qytetare, duke përfshirë pjesemarrjen aktive të këtyre pakicave në proceset vendimmarrës dhe përfshirjen sociale. Projekti "Forcimi i strukturave të Qeverisjes Vendore" i zbatuar nga zyra e Këshillit të Evropës Tiranë, në tre faza 2014-2019, ka ofruar mbështetje dhe ekspertizë në disa drejtime lidhur me forcimin e kapaciteteve të administratës vendore, dhe institucioneve qendrore si DAP, ASPA, etj.

Një nga synimet e programit ROMACTED, i cili është vijueshmëri e programeve ROMED 2 dhe ROMACT, është hartimi i Planit të Veprimit në nivel lokal në shtatë bashki të përzgjedhura[15] nëpërmjet 4 hapave kryesore: Përgatitja e procesit; Vlerësimi i nevojave dhe prioritizimi i tyre; Hartimi i planit të përbashkët të veprimit; Financimi, zbatimi dhe monitorimi. Këto hapa, zbatimi i tyre dhe rezultatet e arrituara për Bashkinë Elbasan paraqiten në seksionet në vijim të këtij dokumenti.

10 Shënim: Funksioni nuk është transferuar plotësisht në NJQV
11 12 Parimet e Qeverisjes së Mirë dhe Etika Europiane e Qeverisjes se Përsosur (ELoGE)
12 Neni 4.2.4 Romët dhe Egjiptianët
13 Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare
14 Deklarata e Strasburgut mbi Romët
15 Bashkia Elbasan, Fier, Vlorë, Gjirokastër, Përmet, Pogradec dhe Roskovec

# III. Metodologjia ROMACTED, procesi dhe aktorët e përfshirë

Metodologjia dhe procesi i përshkuar për hartimin e këtij plani veprimi është konceptuar dhe zbatuar nën një frymë të përgjithshme gjithëpërfshirëse. Kjo është mundësuar duke siguruar që çdo përpjekje e ndërmarrë në këtë kuadër të udhëhiqej nga parimet e fuqizimit, pjesëmarrjes dhe integrimit. Në punën me komunitete në nevojë në përgjithësi, dhe në rastin konkret me komunitetet rome dhe egjiptiane, besohet se fuqizimi apo mundësia për fuqizim e çdo individi është thelbësore për fuqizimin dhe integrimin e gjithë komunitetit. Në këtë prizëm, adresimi i nevojave dhe problematikave përmes një modeli integrues, ku jetët e njerëzve dhe nevojat e tyre shihen, vlerësohen dhe mbështeten nga një këndvështrim multidisiplinar dhe shumëplanësh, kanë qenë në themel të përqasjes sonë.

Ndryshimet, përmirësimet dhe arritjet mund të jenë të qëndrueshme veçse përmes një strategjie të tillë, ku përqasja e integruar nënkupton nevojën për koordinim dhe sinergji në fusha si arsimi, punësimi, përkujdesi shëndetësor, strehimi dhe shërbimet shoqërore. Për arritje të qëndrueshme, gjatë të gjitha përpjekjeve të ndërmarra u inkurajuan dhe zbatuan procese me pjesëmarrje. Pjesëmarrja e komuniteteve në të gjitha proceset i bën ato jo vetëm më të hapura, transparente dhe ndërvepruese, por shton shanset e suksesit dhe i bën proceset dhe rezultatet që vijnë prej tyre më të pranueshme të zbatueshme nga komunitetet e synuara. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të komunitetit rom dhe egjiptian në çdo hap të konceptimit të këtij plani, siguroi ndër të tjera, që edhe të dhënat dhe evidencat e mbledhura për të ushqyer hartimin e këtij plani të ishin të përditësuara dhe të duhura. Ato e përforcuan më tej ndjesinë e pronësisë dhe përgjegjshmërisë për planin dhe zbatimin e tij.  Më konkretisht, procesi për hartimin e planit për integrimin e romëve në nivel vendor kaloi përmes katër hapave kyç, të përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

*Tabela 1. Hapat e procesit për hartimin e planit të veprimit, 2019*

| **Hapi 1. Përgatitja e procesit dhe angazhimi** | **Hapi 2: Vlerësimi i nevojave dhe prioritizimi i tyre** |
|---|---|
| Detyrat e realizuara ishin:<br>a) Identifikimi i aktorëve – përgjatë të cilit iu dha përgjigje pyetjeve "Kush do të përfshihet?" "Pse? Ç'kontribute sjell?"<br>b) Garantimi i angazhimit politik – mundësoi identifikimin e aktorëve të vullnetshëm dhe çoi më tej dejt angazhimit të tyre politik për realizimin e procesit.<br>c) Ngritja dhe mbështjetja teknike për grupet dhe nën-grupet e punës për hartimin e planit. | Vlerësimi i nevojave të komunitetit kaloi përmes:<br>a) Mbledhjes së të dhënave – këtu u përcaktuan burimet e të dhënave, teknikat për mbledhjen e tyre, si dhe indikatorëve/treguesve përkatës.<br>b) Identifikimi dhe prioritizimi i problemeve dhe nevojave – me pjesëmarrjen e komuniteteve u identifikuan problematikat dhe nevojat e tyre si dhe u caktua se çfarë është më prioritare dhe e menjëhershme për adresim në kushtet e burimeve dhe kohës së kufizuar.<br>c) Vlerësimi i kapaciteteve institucionale – ku iu dha përgjigje pyetjeve "Kush mund të bëjë çfarë për adresimin e problematikave/nevojave të identifikuara?". |
| **Hapi 3: Hartimi dhe miratimi i një Plani Veprimi të Përbashkët** | **Hapi 4: Financimi dhe zbatimi i projektit** |
| Hapi i tretë mundësoi hartimin dhe miratimin e planit të përbashkët të veprimit dhe përfshiu reflektim dhe adresim të të mëposhtmeve:<br>a) Reflektim – Çfarë dimë nga procesi i vlerësimit të nevojave dhe prioritizimit të tyre?<br>b) Ku synojmë të arrijmë? Ç'ndryshime duam të sjellim?<br>c) Si? – aktivitete afatshkurtra & afatmesme.<br>d) Integrimi i çështjeve rome në planin vendor – Si? Integrimi si pjesë e së tërës. Planet Sociale.<br>e) Aktivitete/ndërhyrje/ projekte konkrete – Çfarë? Kush? Kur? | Hapi i katërt ndërtoi rrugën drejt një plani të zbatueshëm, duke përfshirë çështje si financimi dhe monitorimi i tij. Gjatë këtij hapi iu dha përgjigje pyetjeve të mëposhtme:<br>a) Sa % e financimit të Planit Vendor do të mbulohet nga buxheti NJVQVsë? A parashikohen financime nga buxheti i shtetit? Donatorët?<br>b) A ka hendek financiar? Cilat janë burimet e mundnshme për financimin e projekteve të reja?<br>c) Sa % e shpenzimeve të Planit Vendor janë të planifikuara në PBAnë 2019-2021?<br>d) A kemi aktivitete/projekte të reja? Sa % të shpenzimeve zënë ato? Si planifikohet financimi i tyre?<br>e) A është hendeku financiar pjesë e kërkesave buxhetore shtesë dhe bisedimeve me donatorë të ndryshëm? |

Me qëllim vlerësimin e nevojave dhe informimin e proceseve vendimmarrëse lidhur me planin përmes të dhënave dhe evidencave u hartua dhe u zbatua një udhëzues për mbledhjen e të dhënave parësore dhe dytësore. Ato përfshinë burime të ndryshme, të përmbledhura në skemën ilustruese më poshtë.




*Figura 1. Burimeve parësore dhe dytësore të të dhënave të përdorura*

Më konkretisht, për mbledhjen e të dhënave parësore përmes teknikave me pjesëmarrjen e komunitetit, u përdorën ushtrimet e hartëzimit të nevojave dhe burimeve, intervista individuale dhe diskutime në grupe (të shoqëruara me vizita dhe vëzhgime në terren), ushtrime për zbërthimin e problematikave si "Matrica e problemit" dhe "Pema e problemit". Të dhëna parësore u mblodhën edhe nga Bashkia, veçanërisht në raport me kapacitetet e saj në funksion të hartimit të këtij plani.

Me qëllim njohjen e thelluar të situatës konkrete në Bashkinë e Elbasanit, identifikimin e problemeve më kritike për pakicat rome dhe egjiptiane dhe prioritizimin e masave fillimisht shërbeu workshopi me lehtësuesit vendorë dhe

anëtarë të Grupit Institucional të Punës (GIP) më 22 Shkurt 2019 në Tiranë dhe më tej takimi me GIP dhe nëpunës publikë të Bashkisë më 28 Shkurt 2019, si dhe takimi me Grupin Komunitar të Veprimit, përfaqësues prej komuniteteve rome dhe egjiptiane më 28 Shkurt 2019.

Në funksion të mbledhjes së të dhënave, u përdorën disa instrumenta si 'analiza e rrjedhës së shkaqeve', pema e problemeve dhe krijimi i hartës së nevojave si dhe pyetësorë për vlerësimin e kapaciteteve institucionale të bashkisë dhe institucioneve të tjera vendore në fushat kryesore të shërbimeve publike jetike për dy komunitetet. Gjithashtu, puna për mbledhjen e të dhënave dhe analizës së situatës, përveç takimeve me fokus grupet dhe specialistët e shërbimeve sociale e të planifikimit të buxhetit u bazua në një konsultim me dokumentat strategjikë të miratuar nga Bashkia si planet e zhvillimit, PPV, buxheti për 2019, planin buxhetor afatmesëm (PBA).

# IV. Analiza Situacionale Vendore

Bashkia Elbasan përpos reformës territoriale dhe administrative (RAT) ka një popullsi prej 141,714 banorësh[16], ndërsa sipas Regjistrit Civil popullsia llogaritet në nivelin e 212,628 banorëve[17]. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 872.03 km$^2$ dhe përbëhet nga 12 njësi administrative[18]. Për të rritur aksesin dhe cilësinë e shërbimeve, janë ngritur zyrat me një ndalesë në të gjitha NJA-të ku ofrohen rreth 100 shërbime. Nëpunësit vendorë kanë marrë pjesë në programe të ndryshme trajnimi si mbi legjislacionin për nëpunësin civil, të drejtat e njeriut, gratë dhe drejtimi (leadership) ofruar nga ASPA dhe programe të donatorëve: UNDP, GIZ, Save the Children, OSFA, etj.

Treguesi i varfërisë së rajonit është në nivelin e 11,3% krahasuar me 14,3%, që është niveli mesatar kombëtar[19]. Sektorë të mundshëm të zhvillimit ekonomik janë industria e përpunimit të metaleve, prodhimi i materialeve të ndërtimit (çimento, etj), shërbimet, transporti dhe bujqësia. Industria, sektori i shërbimeve, ndërtimi e bujqësia janë sektorët kryesorë për ekonominë e rajonit.

Në Bashkinë Elbasan operojnë më shumë se 11,000 entitete biznesi, nga të cilat 308 janë kompani me 10-49 punonjës, dhe rreth 70 kompani me më shumë se 50 punonjës[20]. Në vitin 2018 janë krijuar dhe operojnë 70 biznese të mëdhenj dhe 1870 biznese të vogla të hapura rishtaz[21].

Në territorin e Bashkisë Elbasan kalon rruga kombëtare pjesë e korridorit të VIII-të, si dhe linja hekurudhore Tiranë – Pogradec. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore gjatë viteve të fundit, ka rritur nivelin mesatar të lëvizshmërisë (trafikut) me 6.6%[22]. Pavarësisht progresit, investime të tjera janë të nevojshme për zhvillimin e infrastrukturës rrugore të zonave rurale dhe përmirësimin e standardeve të rrugëve. Rreth 36.5% është niveli i rrjetit rrugor urban ekzistues në territorin e bashkisë, i cili është në përputhje me standardet ligjore të ndërtimit të rrugëve, ndërsa vetëm 6.6% e rrjetit rrugor rural ekzistues sipas standardeve[23]. Ndërkohë, 99% e të gjithë fshatrave të bashkisë (116 gjithsej) janë të lidhura me qendrën e Bashkisë, e cila ka kryer inventarizimin e rrjetit rrugor ekzistues dhe ka hartuar projekte me impakt për zhvillimin e territorit.

---

16 Sipas Census te vitit 2011
17 http://elbasani.gov.al/sq-al/Qyteti/Pages/levizjademografike.aspx
18 www .elbasani.gov.al
19 Burimi: INSTAT – Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës
20 Burimi: Dhoma e Tregtisë, Raport mbi studimin e punësimit të rinjve (Save the Chidren, 2016)
21 Burimi: Bashkia Elbasan
22 Burimi: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
23 Burimi: Treguesit e performancës së Bashkive në kuadër të projektit "Bashkitë për Evropë".

Në vitet e fundit (2017-20018) kanë përfunduar disa projekte zhvillimi në infrastrukturë dhe mjedis (menaxhimi i mbetjeve) si: ndërtimi i rrugës Tiranë-Elbasan; studim, projektim, zbatim i punimeve në aksin rrugor Elbasan – Gjinar; inceneratori i Elbasanit, etj.

*Tabela 2. Investime të përfunduara në vitin 2018, Bashkia Elbasan*

| Autoriteti | Emri i projektit | Plan në SIFQ | Realizimi në % deri në 31.12.2018 |
|---|---|---|---|
| Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve | Rikonstruksion i Ujësjellësit të lagjes " 28 Nëntori" dhe " Skënderbeu " në qytetin e Elbasanit | N/A | 100% |
| Autoriteti Rrugor Shqiptar | Riveshje sistemim asfaltim Rruga Elbasan-Banjë, Loti 1&3 | N/A | 100% |
| Aparati Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë | Rikonstruksion shkolla e AMP "Ali Myftiu", Elbasan | N/A | 100% |

*Burimi: MFE*

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore në vitin 2018 janë rritur me 7.2% krahasuar me vitin 2017 dhe kanë qenë në nivelin 642,180,000 lekë.

## Administrata

Këshilli Bashkiak si organ vendimmarrës kolegjial dhe përfaqësues i Bashkisë përbëhet nga 51 anëtarë, nërsa numri total i nëpunësve vendorë të Bashkisë është 458. Bashkia Elbasan është pjesë e programit të transparencës; rreth 24 takime në procesin e hartimit të Buxhetit për vitin 2019, të cilat janë organizuar nga Bashkia / Drejtoria e Politikave Strategjike, Inovacionit dhe Medias në koordinim me drejtoritë e tjera në vitin 2018 (shkalla e pjesëmarrjes rreth 4456 qytetarë[24]). Bashkia publikon në faqen e internetit buxhetin e saj. Përmes tij ajo ka

24 Burim: Bashkia Elbasan

mbështetur organizata jo-fitimprurëse nëpërmjet dhënies së granteve, në vitin 2018 për zbatimin e 4 projekteve me impakt social në territorin administrativ të saj[25].

Në nivel vendor janë miratur pesë dokumenta të politikave si: Plan i Përgjithshëm Vendor (PPV), Strategjia e Zhvillimit, Plani për Mbrojtjen Sociale, 2017-2022, Plani i Vepirmit për Barazinë Gjinore (2018-2020), Plani Strategjik Anti-korrupsion. Më shumë se 30 fisha të projekteve të reja janë hartuar për t'u financuar nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve dhe projekte me financim të huaj[26], në fusha të tilla si: rehabilitimi i rrugëve, ura dhe energji, ndërtimi të tregjeve për grumbullimin / përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, rehabilitim të zonës industriale (zona e metalurgjikut), menaxhim të zonave të lumit Shkumbin e Zaranikë, rehabilitim të parkut të qytetit (në proces), rehabilitim të fushës së mbetjeve, etj.

Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar (DSHSK) si pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik e Strategjik është një strukturë e rëndësishme e Bashkisë, e cila përbëhet nga disa zyra (sektorë) kryesorë: Sektori i mbrojtjes së fëmijëve dhe barazisë gjinore, Sektori i shtresavë në nevojë dhe moshës së tretë, Sektori i mbrojtjes sociale, PAK dhe Ndihmës ekonomike si dhe nga dy njësi: "Njësia e Vlerësimit të Nevojave të Referimit të Rasteve" dhe "Njësia e Operatorëve Socialë për Asistencën Shtëpiake". Për hartimin e matricës së shërbimeve dhe vlerësimit dhe statistikave në nivel vendor, rol të rëndësishëm luan edhe Drejtoria e Politikave Strategjike, Inovacionit dhe Medias në Bashkinë e Elbasanit, e cila në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit ka mundësuar sigurimin e konsultimeve në procesin e planifikimit të buxhetit dhe buxhetimit gjinor me pjesëmarrje për 2015-2018 në lagjen "5 Maj" dhe zona të tjera:

- Rikonstuksion dhe ndërtim të banesave të pakicave rome dhe egjiptiane.
- Vazhdimi i ndërtimit të KUZ-së në lagjen: "5 Maj" (tek Teqja).
- Ndërtim KUZ pranë shkollës "Sul Domi ", KUZ në Harmas dhe KUZ tek Ara e Prasit (Rr."Arif Dardha")
- Ndërtimii KUZ në lagjen Rrapishtë

25 Fond prej 1,700,000 ALL
26 Burimi: http://elbasani.gov.al/sq-al/Bashkia/Pages/projekteprioritare.aspx

Numri i nëpunësve të administratës vendore përgjegjës për administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e skemës së Ndihmës Ekonomike është 26 (7 nëpunës më shumë krahasuar me vitin 2017), si dhe 18 administratorë socialë të trajnuar për përdorimin e kurrikulave të reja për lehtësimin e aksesit në shërbime për romët dhe egjiptianët. Bashkia ka nënshkruar në vitin 2018 dy Memorandume të Mirëkuptimit me Organizata jo Fitimprurëse (OJF), që ofrojnë shërbime në komunitet.

Stafi i drejtorisë së shërbimit social ka përfituar nga programe trajnimi në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve për zbatimin e sistemit të ri të ndihmës ekonomike (NE) gjatë viteve 2017-2018, trajnime për shërbimet e integruara, të drejtat e njeriut, menaxhimi dhe përditësimi i sistemit ROMALB. Nëntë (9) nëpunës vendorë janë trajnuar në lidhje me politikat kombëtare dhe masat e planifikuara për mbrojtjen sociale e statistikat sociale sipas standardeve të BE-së, në vitin 2018. Fondi vendor i planifikuar për shpenzime të kujdesit social kundrejt buxhetit të Bashkisë ka qenë 9.6% pëgjatë këtij viti.

Bashkia Elbasan ka demonstruar vullnet politik për hartimin e planit vendor për integrimin e romëve dhe egjiptianëve me mbështetje të BE/KiE në kuadër të projektit ROMACTED, 2018-2020.

# V. Metodologjia ROMACTED, procesi dhe aktorët e përfshirë

Në Shqipëri, *romët dhe egjiptianët* janë komunitetet më në nevojë, niveli i varfërisë së këtyre pakicave është dy herë më i lartë krahasuar me shumicën e popullsisë.

Bashkia Elbasan është një nga bashkitë me përqendrim të lartë të pakicave rome dhe egjiptiane, krahasuar me qytete të tjera. Në Bashkinë Elbasan jetojnë rreth 8,460 romë dhe egjiptianë, nga të cilët 2,800 romë dhe 5,660 egjiptianë (ose rreth 1846 familje). Mosha mesatare e pakicës egjiptiane në Elbasan është 5 vjet më e re krahasuar me moshën mesatare të popullsisë së përgjithshme referuar censusit të 2011. Ndërsa përsa i përket gjinisë janë më shumë meshkuj, në masën 50.9% karahasuar me femrat, që janë 49.1%[27]. Komuniteti Egjiptian ka një shpërmdarje më të gjerë krahasuar me komunitetin rom, por zonat me përqëndrim më të madh janë në lagjjet: Beqir Dardha, Dyli Haxhire, Skënderbej, 5 Maji. 331 familje jetojnë në njësitë e tjera administrative: 147 familje në NJA Bradashesh, 138 familje në NJA Shushicë, 41 familje në NJA Papër, 3 familje në NJA Gjinar, 2 familje në NJA Labinot Mal.

Pakica egjiptiane në Bashkinë Elbasan është e shpërndarë në të gjitha lagjet e qytetit, ndërsa pakica rome është vendosur në dy zona kryesore: *zona Rrapishtë* ku jetojnë rreth 400 familje (ose rreth 2800 individë)*; zona afër stadiumit* ku jetojnë rreth 100 familje (570 individë).

Fëmijët romë dhe egjiptianë ndjekin të njejtin program edukimi si fëmijët e tjerë dhe infrastruktura e shkollave është përgjithësisht e mirë. Niveli i frekuentimit të shkollës nga fëmijet e grup-moshës 6 – 15 vjeç ka qënë rreth 261 fëmijë (nga të cilët 106 vajza) në vitin shkollor 2017-2018; 36 raste të braktisjes së shkollës janë evidentuar në vitin 2018 nga të cilët 11 fëmijë rom[28]. Niveli i ulët i frekuentimit të shkollës lidhet me disa faktorë si vështirësitë ekonomike të familjeve rome, kulturën dhe stilin e jetesës (si mungesa e një tradite të ndjekjes së shkollës në familje, jeta nomade, martesat e hershme etj).

Nuk ka raste të segregimit në shkolla, fëmijët romë dhe egjiptianë frekuentojnë të njëjta kopshte dhe shkolla së bashku me fëmijët e tjerë të popullsisë vendore. Në Bashkinë Elbasan nuk ndeshen probleme lidhur me regjistrimin civil, ka patur vetëm raste të pakta të cilat menaxhohen nga shërbimet e bashkisë në

27 Burimi: Studim mbi rregjistrimin e popullsise Egjiptiane, 2016 Levizja Rinore Egjiptiane dhe Rome
28 Burimi: Vëzhgim bazë të komunitetit rom në tetë bashki përfshirë Bashkinë Elbasan (KiE, 2017)

bashkëpunim me aktorët e tjerë vendorë. Fëmijët romë dhe egjiptianë ndjekin të njëjtin program edukimi, por nuk ka të dhëna cilësore mbi arritjet akademike (psh. kalueshmëria apo nota mesatare). Bashkia merr pjesë në bordet e institucionit arsimor dhe në takime me prindërit në shkolla ku zbatohet nisma "Bëjmë detyrat në shkollë".

Problem madhor është niveli i lartë i papunësisë. Si rrjedhojë e mungesës së përgjithshme të punësimit në Shqipëri, rreth 90% e romëve të rritur kanë vështirë të gjejnë një punë, kurse referuar studimit të vitit 2016[29], vetëm 13.9% e personave të rritur egjiptianë rezultuan të punësuar në tregun formal të punës[30]. Në Bashkinë Elbasan, rreth 1098 persona romë dhe egjiptianë kanë një të ardhur nga punësimi kryesisht në tregun informal, në zanate të traditës së tyre, si përpunimi i hekurit, grumbullimi i materialeve të riciklueshme, tregtimi i veshjeve të përdorura, punime me dorë dhe disa zanate të tjera. Niveli ekonomik i familjeve rome është më i ulët se pjesa tjetër e popullsisë dhe pakicave të tjera.

Të dhënat e skemës së Ndihmës Ekonomike në bashki tregojnë se përqindja e familjeve rome përfituese të ndihmës ekonomike është më e lartë se ajo e familjeve të tjera jo-rome. Faktorët që ndikojnë varfërinë e tyre ekonomike janë: numri i lartë i anëtarëve të familjes, shkalla e lartë e papunësisë, sektorët e punësimit ose të vetëpunësimit të romëve nuk krijojnë të ardhura të mjaftueshme, mënyra e jetesës etj. Me gjithë politikat lehtësuese për t'i krijuar kushte për marrjen e një profesioni, kufizimet arsimore të romëve çojnë edhe në kufizime për të përfituar nga skemat nxitëse të punësimit[31]. Për vitin 2018, vetëm 9% e numrit të përgjithshëm të të rinjve, që kanë frekuentuar kurset e formimit profesional në Elbasan, kanë qënë romë.

Në vitin 2018, rreth 107 romë dhe egjiptianë (79 romë dhe 28 egjiptianë) kanë qënë të përfshirë në punë komunitare, nga të cilët 67 gra dhe 40 burra[32]; rreth 344 romë dhe egjiptianë kanë përfituar nga shërbimet e ofruara nga organizata jo fitimprurëse të liçencuara nga MSHMS në përputhje me programet e miratuara dhe Memorandumet e Mirëkuptimit me qeverisjen vendore.

Numri i punëkërkuesve të papunë, që mbulohen nga fondi i bashkisë në kuadër të skemës së Ndihmës Ekonomike ka qënë 120 për vitin 2018. Punësimi i një personi rom ose egjiptian në Zyrën e Punës ose në Bashki do të lehtësonte ndërmjetësimin midis punëkërkuesit, zyrës së shërbimit dhe bizneseve vendore.

---

29
30 Burimi:Studimi mbi popullsinë Egjiptiane, 2016, Lëvizja Rinore Egjiptiane dhe Rome, Ambasada Suedeze dhe Civil Rights Defenders
31 Burimi: Plani Për Mbrojtjen Sociale (2017-2022), Bashkia Elbasan
32 Burimi: Bashkia Elbasan, sistemi ROMALB (2018)

Në Bashkinë Elbasan, ka rreth 6 vite që bashkia është angazhuar me ndërtimin dhe shpërndarjen e banesave sociale, ashtu si edhe me realizimin e disa projekteve të rikonstruksionit të banesave ekzistuese. Ndonëse Bashkia Elbasan ka lobuar pranë donatorëve për bashkëfinancim në plotësimin e disa nevojave specifike të pakicave rome dhe egjiptiane, si CRCA, GTZ, Roma Education Fund, Agjencinë e Zhvillimit të Rajoneve, ekziston hendek i konsiderueshëm midis nevojave të pakicave rome dhe egjiptiane dhe burimeve financiare të Bashkisë.

*Tabela 3. Problemet dhe Nevoja për Ndryshim sipas gjetjeve në Fokus Grup të Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë Elbasan*

| Probleme | Nevoja / Ide për ndryshime |
|---|---|
| • Ka anëtarë të pakicave pa karta identiteti<br>• Punësimi i pjesëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane në nivele të ulta<br>• Braktisja e shkollës pa përmbushur arsimin 9-vjeçar.<br>• Qendra e formimit profesional është larg vendbanimit të pakicave.<br>• Vendet për të tregtuar rrobat e përdorura janë të pamjaftueshme.<br>• Fëmijët e pakicave nuk kanë hapësira argëtimi.<br>• Mungojnë kanalizimet në disa zona të lagjes « 5 Maj – Rrapishtë », asfaltimi dhe ndriçimi i lagjes "5 Maj-Rrapishtë". | • Punësim sezonal në projektet infrastrukturore që zbaton Bashkia Elbasan dhe punësimi në programet e Zyrës së Punës.<br>• Integrimi urban i zonës Rrapishtë.<br>• Ndërgjegjësim i komunitetit nga institucionet dhe OJF-të.<br>• Rritja e buxhetit të Bashkisë Elbasan dedikuar programit të Bonusit të Strehimit, në mënyrë që të subvencionohen në pagesën e qerasë më shumë familje.<br>• Miratimi i buxhetit të Bashkisë Elbasan për programin e "Përmirësimit të banesave ekzistuese" në mënyrë që 20% e buxhetit të këtij programi që mbulohet nga bashkia të jetë i mjaftueshëm për më shumë se 50 familje në vit.<br>• Krijimi i fondit social të banesave, në zbatim të ligjit të ri të strehimit. |

| | |
|---|---|
| • Banesa në kushte të vështira.<br>• Rreth 180 familje egjiptiane jetojnë në banesa të papërshtatshme, që kanë nevojë për rikonstruksion.<br>• Mbi 50% e familjeve në kushte me 2 ose më shumë kurora në të njëjtën banesë.<br>• Probleme me blerjen e ilaçeve për shkak të pamundësisë financiare.<br>• KUZ tek shkolla “Hamit Mullisi”<br>• Lindjet në moshë të hershme<br>• Migrimi | • Të përshpejtohet procesi i legalizimit të banesave të pakicave rome dhe egjiptiane, që janë në tejkalim të afateve ligjore.<br>• Mbështetje nga Bashkia për të mundësuar transportin e të interesuarve për kurse të formimit profesional pranë DRAFP, Elbasan.<br>• Hapja e një tregu të ri.<br>• Ndërtimi i një parku lojrash pranë Lagjes “5 Maj – Rrapishtë”.<br>• Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve të zonës së banimit në Lagjen 5 – Rrapishtë.<br>• Përmirësimi i kushteve të banimit (banesat e komunitetit rom). Krijimi i një ambjenti të gjelbër dhe këndi lojrash për fëmijët.<br>• Hapja e një salle interneti.<br>• Mbështetje financiare për aktivitetet që zhvillohen nga qendra komunitare.<br>• Kurse dhe trajnime për stafin e qendrës.<br>• Ofrimi i një vakti ushqimor për fëmijët. |

# Vlerësimi i nevojave sipas fushave prioritare

## V.1. Arsimi

Romët dhe egjiptianët në Shqipëri gëzojnë statusin e pakicave kombëtare dhe si të tilla ato duhet të gëzojnë edhe të drejtat që u lindin në fushën e arsimit. Fëmijët romë dhe egjiptianë kanë përqindje të ulët të regjistrimit në shkollë dhe përfundimit të shkollës krahasuar me mesataren kombëtare. Rreth 40,3% e romëve dhe 12,7% e egjiptianëve janë analfabetë, ndërsa mesatarja kombëtare është vetëm 1,6%[33]. Një nga qëllimet strategjike të PKVIRE 2016-2020 është që romët dhe egjiptianët të gëzojnë akses dhe përfshirje të plotë në arsim cilësor duke mos qenë subjekt i diskriminimit dhe segregimit.

Një numër i madh nxënësish romë braktisin arsimin e detyruar si pasojë e mungesës së mbështetjes së nevojshme në shkollë, për shkak të nevojës për të ndihmuar familjen me të ardhura, por edhe si pasojë e diskriminimit.[34] Mjaft familje rome që përballen me përjashtimin social, besojnë se vajza e tyre do të jetë më e mbrojtur nëse e braktis shkollën në vitet e para të adoleshencës dhe përgatitet për të krijuar familjen e saj[35].

Bashkia Elbasan ka 109 kopshte me kapacitet prej 4451 fëmijësh, nga të cilat 16 kopshte publike në qytet, 13 klasa përgatitore, 73 kopshte në njësi administrative, të cilat janë lokalizuar brenda dhe jashtë godinave të shkollave, si dhe 8 kopshte private. Shkalla e regjistrimit të fëmijëve të grupmoshës 3-6 vjeç në kopshte është 26% kundrejt numrit total të fëmijëve në Bashkinë Elbasan në vitin 2018. Rreth 84 fëmijë romë dhe egjiptianë të grup-moshës 3-5 vjeç kanë ndjekur kopshtet dhe sistemin parashkollor në vitin 2018[36].

Në territorin e Bashkisë Elbasan funksionojnë gjithsej 91 shkolla 9-vjeçare publike dhe jopublike, nga të cilat vetëm 5 shkolla frekuentohen nga një numër i konsiderueshem fëmijësh romë dhe egjiptianë. Infrastruktura shkollore është përgjithësisht sipas standardeve, përveç rastit të shkollës "Hamit Mullisi", e cila ka nevojë për rikonstruksion të plotë. Ndërkohë projekte të reja janë në fazë përgatitjeje për 6 shkolla 9-vjeçare ne disa njësi administrative, një shkollë profesionale dhe dy shkolla në qytet. Bazuar në të dhënat e "Vëzhgim bazë të KiE, 2017", rreth 261 fëmijë të grup-moshës 6-15 vjeç kanë frekuentuar rregullisht

33 Burim: Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Raportii Monitorimit (2017)
34 Sipas studimit të OSFA-s, 4% e fëmijëve të moshës 6-17 vjeç janë të angazhuar në punë të ndryshme.
35 Sipas anketës social-ekonomike të vitit 2011, 31% e vajzave rome dhe 13,6% e vajzave egjiptiane midis moshës 13 - 17 vjeç ishin të martuara.
36 Burimi: Bashkia Elbasan

shkollën, nga të cilët 106 vajza në vitin shkollor 2017-2018; 36 raste të braktisjes së shkollës janë evidentuar në vitin 2018, nga të cilët 11 fëmijë rom.

*Tabela 4. Mbi frekuentimin e sistemit parashkollor dhe arsimit të detyrueshëm, në Bashkinë Elbasan (2018)*

| | Gjithsej | Vajza | Djem | Romë | Egjiptianë |
|---|---|---|---|---|---|
| Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë që ndjekin rregullisht çerdhet | 3 | 1 | 2 | - | - |
| Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë të përjashtuar nga tarifat për ndjekjen e arsimit parashkollor | 64 | 37 | 39 | 76 | 0 |
| Numri i fëmijëve romë dhe Egjiptianë të mbështetur nga mësues dhe ndihmës per detyrat e shtëpisë (për vitin shkollor 2017-2018) | 266 | N/A | N/A | 91 | 175 |
| Numri i nxënësve dhe studentëve romë dhe egjiptianë që përfitojnë bursa në nivele të ndryshme arsimore (mbi 18 vjeç) | 52 | 8 | 44 | 0 | 52 |
| Numri i grave rome dhe egjiptiane që punojnë në pozicione ndihmëse në arsimin parashkollor dhe arsimin e detyrueshëm | 8 | 8 | - | 1 | 7 |

*Burimi: Bashkia Elbasan*

Bashkia në bashkëpunim me DAR ka ndërmarrë 3 fushata ndërgjegjësimi ndaj prindërve për përfshirjen e fëmijëve në sistemin e arsimit parashkollor. Fondi i investimit vendor për ndërtimin ose rikonstruksionin e kopshteve dhe çerdheve ekzistuese ka qënë 0.1% e buxhetit vendor për vitin 2018 (2 milion lekë); fondi vendor për të siguruar përfshirjen në regjistrimin dhe ndjekjen e shkollës të arsimit bazë nga fëmijë të grupeve të margjinalizuara (rome dhe egjiptiane) ka qënë rreth 0.1% e buxhetit vendor për sektorin e arsimit; fondi i investimit vendor për ndërtimin e shkollave të reja dhe rikonstruksionin e shkollave ekzistuese ka qënë 1.7% e buxhetit vendor.

Gjatë viteve të fundit, Bashkia raporton se janë ndërmarrë disa masa lehtësuese nga qeveria si përfshirja e teksteve shkollore dhe transporti falas për fëmijët që ndjekin arsimin e detyrueshëm, vizitat në shtëpi, ndihmën me detyrat e shtëpisë, mësimin e gjuhës dhe seminareve për prindërit. Megjithatë, kjo nuk u raportua nga përfaqësues të pakicave rome dhe egjiptiane gjatë procesit të vlerësimit të nevojave.

## V.2 Shëndetësia

Perceptimet e pakicave rome dhe egjiptiane janë se shërbimi shëndetësor dhe aksesueshmëria e këtyre komuniteteve në këto shërbime është përgjithësisht e mirë. Elbasani ka 53 Qendra Shëndetësore, nga të cilat 4 janë në qytet dhe 49 në zonat e tjera administrative. Numri i punonjësve të shëndetësisë të qëndrave dhe spitalit publik është 581. Bashkia Elbasan nuk ka qendra shëndetësore, të cilat të jenë në një distancë më të madhe se 5 km nga zonat me përqendrim të lartë të komunitetit rom dhe egjiptian.

Pothuajse të gjithë fëmijët romë dhe egjiptianë jane vaksinuar me të paktën tre dozat bazë (vaksinat deri në gjashtë muajt e parë të lindjes), por problem mbetet vaksinimi jo i rregullt i tyre me këto vaksina në periudhat pasuese[37].

## V.3 Punësimi

Varfëria mund të shprehet si një akses i pamjaftueshëm dhe formë deprivimi nga shërbimet, burimet dhe mjetet e vlefshme për shumicën e popullatës, ose si pamundësi per të përfituar maksimalisht nga shërbimet publike. Dy kanë qenë masat kryesore të ndërmarra nga qeveria për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në jetën ekonomike të vendit: (i) integrimi i pakicave rome dhe egjiptiane në tregun e punës nëpërmjet formimit profesional dhe programeve aktive të punësimit, (ii) nxitja dhe mbështetja për krijimin e bizneseve të reja, nxitjes së vetë-punësimit dhe formalizimit të punës.

Në nivel kombëtar, rreth 880 romë dhe egjiptianë janë punësuar nga zyrat e punës në vitin 2017, përfshirë individët që kanë qenë pjesë e programeve të nxitjes së punësimit, si dhe nëpërmjet ndërmjetësimit[38]; 83 studentë romë dhe egjiptianë janë këshilluar për të lehtësuar hyrjen dhe integrimin në tregun e punës.

37 Burim: Plani i Veprimit te Mbrojtjes Sociale të Bashkisë Elbasan, 2016-2020
38 Burimi: Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Raporti i Monitorimit (2018)

Sipas statistikave në nivel bashkie rezultojnë rreth 1098 romë dhe egjiptianë të punësuar, nga të cilët 314 janë gra. Ndërkohë, OSHC-të dhe përfaqësues të këtyre komuniteteve nuk i konfirmojnë këto shifra. Numri i të papunëve që marrin ndihmë ekonomike të cilët janë mbështetur financiarisht nga Bashkia për arsim dhe trajnim profesional ka qënë 140 në vitin 2018[39]. Numri i hapësirave të caktuara tregtare të përdorura nga romët dhe egjiptianët është tre (3) në Bashkinë Elbasan. Përgjithësisht, pretendohet se pakicat rome dhe egjiptiane nuk kanë interesim të vazhdueshëm dhe periodik për të aksesuar shërbimet e punësimit, që ofrohen pranë Zyrave të Punës dhe për të kuptuar përfitimet që rrjedhin nga regjistrimi si punëkërkues i papunë në programet e nxitjes së punësimit apo për orientim drejt kurseve të formimit profesional. Kjo bie ndesh me procesin dhe kushtet për përfitimin e Ndihmës Ekonomike, që kërkon shprehjen e vazhdueshme të interesit për punësim.

*Tabela 5. Të dhëna mbi punësimin e romëve dhe egjiptianëve, Elbasan 2018*

| | Gjithsej | Gra | Burra | Romë | Egjiptianë |
|---|---|---|---|---|---|
| Punëkërkues të regjistruar në zyrat e punës | 864 | N/A | N/A | 466 | 398 |
| Numri i personave të përfshirë në programet e nxitjes së punësimit | 66 | N/A | N/A | N/A | N/A |
| Numri i personave të regjistruar si punëkërkues të papunë dhe të punësuar nëpërmjet Shërbimit të Punësimit (DRSHKP, Elbasan) | 44 | N/A | N/A | N/A | N/A |

*Burimi: Drejtoria Rajonale e Punësimit Elbasan*

Numri i të rinjve romë që frekuentojnë kurset e formimit profesional është i ulët, nga 34 të rinj (12 femra) të regjistruar në shërbimin e arsimit të formimit profesional[40] për vitin 2018, janë vetëm 3 të rinj romë (ose 9%). Kurset e ndjekura pranë qendrës rajonale të formimit profesional në Elbasan kanë qenë për profesione të tilla si: ndërtim, saldim, berber, parukeri, rrobaqepsi, kujdes ndaj moshës së tretë, kuzhinier, mekanikë-auto. Statistikat e DRAFP në Elbasan evidentojnë që 29% e të rinjve janë

39 Burimi:Bashkia Elbasan
40 DRAFP, Elbasan

skualifikuar, 29% kanë përfunduar me sukses kurset e formimit profesional dhe janë çertifikuar, ndërsa të tjerët janë në ndjekje të kurseve.

## V.4 Mbrojtja Sociale

Organizimi i shërbimit social në nivelin vendor realizohet mbi bazën e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale, 2015 -2020[41] dhe i parimeve kryesore si e drejta civile, barazia dhe mosdiskriminimi, mbrojtja për grupe të veçanta, përfshirë fëmijët bazuar në nevojat e tyre, e drejta e jetës dhe zhvillimit, pavarësia, autonomia dhe respektimi i pikëpamjeve, përfshirja dhe integrimi mbi bazën e respektimit të të drejtave dhe nevojave të njeriut, sigurimi i partneritetit me institucionet qendrore, komunitetet dhe organizatat e shoqërisë civile dhe sigurimi i standardeve kombëtare të shërbimit.

Në Bashkinë Elbasan është kryer vlerësimi i nevojave për shërbime sociale dhe i kapaciteteve të institucioneve vendore për të adresuar parime thelbësore duke iu referuar nevojave dhe specifikave vendore të Bashkisë Elbasan, si pjesë e hartimit të Planit Vendor për Mbrojtjen Sociale, 2017-2022. Numri i ekipeve të lëvizshme të Drejtorisë të Kujdesit Social dhe Komunitar në monitorimin dhe vlerësimin e nevojave në terren është gjashtë (6).

Në Elbasan funksionojnë 11 qendra, që ofrojnë shërbime të kujdesit social përfshirë një qendër për fëmijët me autizëm ,të cilat ofrojnë shërbime për katër kategori të cenueshme: fëmijët, mosha e tretë, PAK dhe pakicat. Rreth 315 persona kanë përfituar nga shërbimet e qendrave të kujdesit social në vitin 2018, prej të cilëve 200 fëmijë, 85 të moshuar dhe 30 PAK[42], ndërsa numri i qendrave komunitare, që ofrojnë shërbime të integruara të kujdesit social janë 2. Në vitin 2018, rreth 187 persona kanë përfituar nga këto dy qendra të integruara, 127 romë dhe 60 egjiptianë (134 gra, 53 burra).

---

41 Tre shtyllat kryesore të strategjisë janë (i) Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë, duke mundësuar mbulimin më të mirë të familjeve dhe individëve të varfër dhe ekstremisht të varfër, përmirësimin e shenjëstrimit të tyre, rritjen e transparencës dhe shmangien e abuzivitetit në skemën e Ndihmës Ekonomike, si dhe lidhjen me shërbime të integruara dhe skemat e punësimit, me qëllim integrimin social të tyre, (ii) Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuar, nëpërmjet vlerësimit biopsiko- social bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të aftësisë së kufizuar, duke ndërthurur skemën e pagesave në cash me shërbime të integruara, me qëllim integrimin në jetën shoqërore dhe ekonomike, (iii) Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit social, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e Mbrojtjes Sociale, si dhe inkurajimi i pjesëmarrjes se plotë dhe efektive në shoqëri.

42 Burim: Bashkia / Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar (Mars 2019)

Rreth 6,536 persona me aftësi të kufizuar (PAK) kanë përfitur nga skema e mbrojtjes sociale (ose 780 persona më shumë se viti 2017); 12 të moshuar janë strehuar në shërbimin rezidencial.

*Tabela 6. Të dhëna mbi NE dhe programin e mbrojtjes sociale, Bashkia Elbasan (2018 dhe 2019)*

| | Gjithsej | Gra | Burra | Romë | Egjip-tianë |
|---|---|---|---|---|---|
| Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që përfitojnë ndihmë ekonomike (2019) | 631 | - | - | 158 | 473 |
| Numri i individëve romë dhe egjiptianë që përfitojnë ndihmë ekonomike (2019) | 2262 | 986 | 1276 | 608 | 1654 |
| Numri familjeve rome dhe egjip-tiane që kanë përfituar bonusin për shpërblimin e lindjes (2018) | 13 | | | 7 | 6 |
| Numri i familjeve të përfshira në skemën e NE që përfitojnë edhe nga shërbime të tjera falë referimit nga administratori social (2018) | 215 | - | - | 106 | 109 |
| Numri i romëve dhe egjiptianëve në rrezik të informuar rreth rre-ziqeve të trafikimit të qenieve njerëzore, shërbimeve të dispo-nueshme për viktimat e mënyra-ve për promovimin e riintegrimit të tyre (2018) | 217 | 136 | 81 | 125 | 92 |
| Numri i organizatave rome dhe egjiptiane të licencuara dhe/ose që kanë Memorandum Mirëkup-timi me NJQV për ofrimin e shërbimeve në komunitet (2018) | 5 | - | - | 4 | 1 |
| Memorandum Mirëkuptimi me NJQV për ofrimin e shërbimeve në komunitet (2018) | 5 | - | - | 4 | 1 |

*Burimi: Bashkia Elbasan, sistemi ROMALB*

Familjet më të varfra që nuk përmbushin kriteret e skemës së NE janë subjekt i vendimmarrjes së Bashkisë për t'u përkrahur në kuadër të fondit prej 6% të skemës së NE. Punonjesit socialë të Sektorit të NE kryejnë vizita në terren për familjet/individët që kanë dalë nga skema, përfshirë romë dhe egjiptianë dhe ofrojnë asistencë në plotësimin e formularit dhe dokumentacionit gjatë procesit të aplikimit.

## V.5 Qendra komunitare

Qendra komunitare në zonën e Rrapishtës, ofron shërbime asistence për 45 fëmijë në përgatitjen e detyrave si dhe për fëmijë, që e kanë braktisur shkollën. Këta të fundit janë pjesë e aktiviteteve ndërgjegjësuese, kulturore dhe artistike, veprimtarive sportive, për edukimin qytetar dhe shëndetësor. Rreth 61 fëmijë të grup-moshës 3- 6 vjeç frekuentojnë kopshtin, që funksionon në të njëjtën strukturë me Qendrën Komunitare. Gjatë 3 viteve të fundit, qendra komunitare nuk ka pasur donatorë dhe asistencë [43].

## V.6 Strehimi dhe infrastruktura urbane

Bashkia Elbasan ka burime njerëzore për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve për përmirësimin e banesave si dhe për projekte zhvillimi të infrastrukturës urbane. Ajo ka përgatitur disa studime fizibiliteti dhe fisha projekti, por burimet financiare të Bashkisë janë të kufizuara dhe nuk plotësojnë nevojat për përmirësimin e banesave të identifikuara si problematike si dhe ndërtimin e banesave sociale. Ligji për strehimin social[44] përcakton rregullat dhe procedurat administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe shpërndarjes së banesave sociale. Sipas ligjit, Bashkia duhet të financojë 20% të fondit të nevojshëm për projekte rehabilitimi/rikonstruksioni dhe ndërtimin e banesave sociale si bashkëfinancim në aplikime pranë MFE, në kuadër të programeve për strehimin social.

---

43 Burimi: Qendra Komunitare ne zonën e Rrapishtës
44 Ligji për Strehimin Social Nr. 22/2018

*Tabela 7. Përmirësimi i banesave dhe projekte të integrimit urban për periudhën 2016-2019 (në Lekë)*

| Projekti | Fondi | Viti | Burimi i financimit | Statusi | Numri i familjeve përfituese |
|---|---|---|---|---|---|
| Përmirësimi i kushteve të banimit të romëve | 30,427,631 | 2019 | Qeveria / FSHZH | ?? | N/A |
| Ndërtimi i KUZ-ve tek lagja Rrapishtë/L.6 | 4,185,422 | 2018 | Qeveria | Përfun-duar | 400 familje rome |
| Sistemim asfaltim i rrugës Nusret Kokobobo dhe i shesheve të pallateve nr. 60, 61, 62 63/1, 64/3, lagjja Emin Matraxhiu, Elbasan/ L.1 | 42,340,034 | N/A | Qeveria | Përfu-nduar | N/A |
| Sistemim-Asfaltim rruga "Ahmet Hastopalli dhe sheshet e pallateve", Lagja "Beqir Dardha / L.1 | 20,637,016 | N/A | Bashkia | Përfu-nduar | N/A |
| Ndërtimi i rrugës "Sule Domi" (vazhdim), nga lo-kali Rexhep Kukës deri tek ura e sektorit, Lagja "5 Maji"/L.6 | 10,017,200 | N/A | Bashkia | Përfu-nduar | N/A |
| Vazhdim i ndertimit te KUZ-se në lagjen: "5 Maj" (tek Teqja)/L.6 | 7,980,000 | N/A | Bashkia | Përfu-nduar | N/A |
| Ndërtim i 4 mjediseve sportive në shkollat e qytetit Elbasan: Shkollat: Sul Harri, Adem Krasniqi, Naim Frasheri dhe Abdyl Paralloi. | 9,957,081 | N/A | Bashkia | Përfu-nduar | Përfitues edhe nga pakicat rome dhe egjiptiane |
| Zbatimi i katër projekteve me impakt social | 1,700,000 | 2018-2019 | UNDP/Bash-kia/OSHC | Në proces | N/A |

Në kuadër të programit të strehimit social nëpërmjet financimit të bonusit të qerasë kanë përfituar gjithsej 24 familje rome dhe egjiptiane, nga të cilat 7 familje rome dhe 17 familje egjiptiane në vitin 2018.

Problematikë e vështirë janë kushtet e banesave të familjeve që jetojnë në zonën e *Rrapishtës* ku jetojnë 400 familje rome. Ndonëse Bashkia ka realizuar në vitet e fundit një ndërhyrje për përmirësimin e disa banesave, mbetet problematike cilësia e dobët e banesave, infrastruktura e ujësjellës-kanalizimeve, infrastruktura rrugore dhe ndricimi i rrugëve. Rreth 289 familje rome kanë aplikuar për legalizimin e pronës (procesi është në vijim), 23 familje rome jetojnë në banesa të pa legalizuara[45].

*Në Njësinë Administrative Bradashesh*: rreth 50 familje kanë probleme me marrjen e dokumentit të pronësisë. Këto familje jetojnë në pallatet e ndërtuara nga ish-punëtorët e Kombinatit Metalurgjik (vitet 1980).

*Në Lagjen "Dyli Haxhire", Rruga "Ilir Shehu"* jetojnë mbi 100 familje të komunitetit egjiptian, ku 50 familje përballen me mungesën e furnizimit të rregullt me ujë të pijshëm në pjesën e sipërme të rrugës. Gjithashtu, ka probleme me rrugën kryesore e cila është e amortizuar, pa asfalt dhe ndriçim, si dhe vonesa në procesin e legalizimit të pronës.

*Në lagjen "Skënderbej", tek stacioni i trenit* jetojnë mbi 100 familje të komunitetit egjiptian që jetojnë në banesa me probleme, infrastrukturë e dobët e zonës së banimit, dhe me probleme të furnizimit me ujë të pijshëm në zonën e verës.

## V.7 Regjistrimi civil

Problem i përbashkët në shkallë vendi është mungesa e statistikave të sakta (të dhënat janë indikative) për sa kohë pranohet që kemi fëmijë romë të paregjistruar në gjendje civile dhe për sa kohë nuk ekziston një listë e plotë për fëmijët romë 3-5 vjeç. Në Bashkinë Elbasan raportohet se 25% e romëve nuk kanë dokumenta të identitetit[46].

45 Burimi: Vëzhgim i KiE në tetë bashki (2017)
46 Burimi: KiE, Vëzhgim bazë për romët dhe egjiptianët (2017)

*Tabela 8. Regjistrimi i romëve dhe egjiptianëve, Bashkia Elbasan*

| | Gjithsej | Vjaza/ Gra | Djem/ Burra | Romë | Egjiptianë |
|---|---|---|---|---|---|
| Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë të lindur dhe të identifikuar si të paregjistruar | 76 | 37 | 39 | 76 | 0 |
| Numri i personave të cilëve nuk u përputhet vendbanimi sipas zyrës së gjendjes civile me banimin real | 0 | - | - | - | - |

# VI. Vizioni dhe Objektivat e Planit Vendor

**Vizioni:** Rritja e aksesit në shërbimet publike nëpërmjet heqjes së vazhdueshme të barrierave për romët dhe egjiptianët gjatë katër viteve të ardhshme do të sjellë një shëndet më të mirë, një arsimim më të plotë, rritje të *mirëqenies nëpërmjet punësimit formal e si pasojë integrim të plotë të* pakicave rome dhe egjiptiane.

**Qëllimet Strategjike**:

- Lehtësimi i mundësive për shfrytëzimin e barabartë të shërbimit të regjistrimit civil dhe drejtësisë për romët dhe egjiptianët.

*Synimi: Në fund të vitit 2020, 100% e anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane do të kenë akses të plotë në shërbimin e gjendjes civile.*

- Romët dhe egjiptianët të gëzojnë akses dhe përfshirje të plotë në arsim cilësor duke mos qenë subjekt i diskriminimit dhe segregimit.

*Synimi: Në fund të vitit 2020, 70% më shumë djem dhe vajza të pakicave rome dhe egjiptiane arrijnë të përfundojnë të gjitha nivelet e arsimit dhe 100% përfundojnë arsimin parashkollor.*

Krijimi i mundësive të barabarta për punësimin formal të romëve dhe egjiptianëve.

*Synimi: 80% më shumë gra dhe burra romë dhe egjiptianë të cilët marrin pjesë në AFP dhe programet aktive të punësimit do të integrohen në tregun e punës deri në fund te vitit 2020.*

- Garantimi i një kujdesi mjekësor të aksesueshëm, të përballueshëm dhe të barabartë për romët dhe egjiptianët.

*Synimi: 100% e anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane do të kenë mundësi të përdorin shërbimet bazë shëndetësore deri në fund të vitit 2020.*

- Përmirësimi i kushteve të strehimit për romët dhe egjiptianët.

*Synimi: 80% e familjeve rome dhe egjiptiane, të cilët kanë nisur procedurat e legalizimit, i kanë përfunduar ato me sukses deri në fund të vitit 2020.*

- Rritja e aksesit në programet e mbrojtjes sociale për anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane.

*Synimi: 30%* më shumë e anëtarëve *të pakicave rome dhe egjiptiane do të jenë të përfshirë në programet e mbrojtjes sociale deri në fund të vitit 2020.*

# VII. Plani i Masave

| Fusha e ndërhyrjes: Akses i Barabartë në Regjistrimin Civil dhe në Drejtësi | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Objektivi specifik: Lehtësimi i mundësive për shfrytëzimin e barabartë të shërbimit të regjistrimit civil dhe drejtësisë për romët dhe egjiptianët<br><br>Treguesi i Objektivit: Përqindja e anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane do të kenë akses të plotë në shërbimin e gjendjes civile deri në fund të vitit 2020. | | | | | | |
| Masa/Aktiviteti | Aktorët | Treguesit e rezultateve | Burimet e të dhënave | Afatet | Fondet/ Financimi | Monitorimi |
| 1.1.1 Dhënia e ndihmës për marrjen e dokumenteve për fëmijët e lindur jashtë vendit | Zyra e Gjendjes Civile (ZGJC), NJMF dhe organe të tjera relevante | Baza e referimit – viti 2018. Indikatorë të matshëm çdo vit. | Raport i paraqitur nga ZGJC në Bashki | Çdo 6-mujor | 2,400,000 | Drejtoria e Shërbimit Social (DSHS) në Bashki |
| 1.1.2 Raportimi pranë zyrave të gjendjes civile i fëmijëve të paregjistruar, përfshirë ata që janë lindur brenda dhe jashtë institucioneve shëndetësore | Zyra e Gjendjes Civile, NJMF dhe organe të tjera relevante, Dega e Policisë së Shtetit | Indikatorë të matshëm çdo vit. | Raport i paraqitur nga ZGJC në Bashki | Çdo 6-mujor | 320,000 | Drejtoria e Shërbimit Social (DSHS) në Bashki |
| 1.1.3 Regjistrimi dhe zgjidhja, përmes zyrave të gjendjes civile, i rasteve të individëve të paregjistruar, të cilët nuk janë të pajisur me dokumentacionin e nevojshëm. | ZGJC | Baza e referimit (2018, 76 raste të fëmijeve romë të pa regjistruar | Raport i paraqitur nga ZGJC në Bashki | Çdo 6-mujor | 1,869,600 | Drejtoria e Shërbimit Social (DSHS) në Bashki |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.1.4 Hartimi dhe shpërndarja e paketave të informacionit mbi kriteret, dokumentacionin e nevojshëm dhe burimet e mbështetjes për romët dhe egjiptianët në lidhje me regjistrimin civil dhe transferimin e vendbanimit | ZGJC/DSHS | Numri i romëve dhe egjiptianëve të informuar rreth procedurave të regjistrimit civil dhe ndryshimit të vendbanimit,<br><br>Ndarja sipas: etnicitetit. | Raport i paraqitur nga ZGJC/ DSHS në Bashki | Çdo 6-mujor | 242,880 | Drejtoria e Shërbimit Social (DSHS) në Bashki |
| 1.1.5 Dhënia e bonusit për shpërblimin e lindjes së fëmijëve romë dhe egjiptianë në rast regjistrimi brenda afatit ligjor. | Zyra e GJC, DSHS | Numri familjeve rome dhe egjiptiane, që kanë përfituar bonusin për shpërblimin e lindjes.<br><br>Ndarja sipas etnisë. | Raport i paraqitur nga ZGJC/ DSHS në Bashki | Çdo 6-mujor | 24,000,000 | Drejtoria e Shërbimit Social (DSHS) në Bashki |

| Objektivi 2: Fuqizimi i kapaciteteve për identifikimin e romëve dhe egjiptianëve në rrezik trafikimi si dhe referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e rasteve të trafikuara.<br><br>Treguesi i objektivit: Deri në fund të vitit 2020, 80% e anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane do të jenë përfshirë në aktivitete ndërgjegjësuse mbi mënyrat e trafikimit të qënieve njerëzore si dhe 100% e rasteve të identifikuara si të trafikuara do të jenë marrë në mbrojtje dhe asistohen me shërbimet e riintegrimit të tyre në shoqëri. | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.2.1. Përmirësimi i funksionimit të mekanizmit ekzistues për shkëmbimin e informacionit nga institucione të ndryshme, (duke përfshirë informacionin dhe të dhënat e disagreguara mbi viktimat e pakicave rome dhe egjiptiane) | DSHS, grupet e menaxhimit te rasteve | Numri i viktimave të mundshme të trafikimit dhe viktimave të identifikuara të trafikimit, që janë referuar dhe kanë marrë ndihmë (M/F) | Bashkia/ sistemi SIVET (sistemi i informacionit për viktimat e trafikimit) | Çdo 6-mujor | 384,000 | Drejtoria e Shërbimit Social (DSHS) në Bashki |

| Fusha e ndërhyrjes: Arsimi dhe Promovimi i Dialogut Ndërkulturor | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Objektivi specifik2.1: 100% e **fë**mij**ë**ve (djem dhe vazja) të pakicave rome dhe egjiptiane të përfundojnë arsimin e detyruesh**ë**m dhe arsimin parashkollor në fund të vitit 2022.<br><br><u>Treguesi 1:</u> Përqindja e fëmijëve, djem dhe vazja, të pakicave rome dhe egjiptiane që arrijnë të përfundojnë arsimin e detyrueshëm dhe arsimin parashkollor në fund të vitit 2022.<br><br><u>Treguesi 2</u>: % e institucioneve arsimore që frekuentohen nga djem dhe vajza rome dhe egjiptiane që promovojnë dialogun ndërkulturor dhe atë të mirëkuptimit të përbashkët nëpërmjet zhvillimit të komuniteteve mbi bazë shkolle, deri në fund të vitit 2020. | | | | | | |
| Masa/Aktiviteti | Aktorët | Treguesit e rezultateve | Burimet e të dhënave | Afatet | Fondet/ Financimi | Monitorimi |
| 2.1.1 Regjistrimi i të gjithë fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsimin parashkollor dhe arsimin e detyrueshëm | Zyra Arsimore dhe DSHS | Baseline: 261 fëmijë romë dhe egjiptianë të regjistruar në arsimin bazë në vitin 2018<br><br>84 fëmijë romë dhe egjiptianë të moshës 3-5 vjeç frekuentuar kopshtet dhe arsimin para-shkollor (2018)<br><br>Numri i djemve dhe vajzave rome dhe egjiptiane të regjistruar dhe që ndjekin arsimin parashkollor dhe arsimin e detyruar.<br><br>Ndarja M/F, etnicitetit, qytet/fshat. | Raport i paraqitur nga DSHS/ Zyra e Arsimit | Çdo 6-mujor | 431,200 | Drejtoria e Shërbimit Social (DSHS) në Bashki, Zyra e Arsimit në Bashki, Drejtoria Arsimore në Elbasan |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1.2 Regjistrimi i fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsimin parashkollor dhe atë të detyrueshëm duke i përjashtuar ata nga garancitë financiare dhe pagesat për ushqim. | Bashkia / DSHS | Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë të përjashtuar nga tarifat për ndjekjen e arsimit parashkollor. Të dhëna të disagreguara: sipas M/F, etnicitetit; qytet/fshat. | Raport i paraqitur nga DSHS | Çdo 6-mujor | 818,400 | Drejtoria e Shërbimit Social (DSHS) në Bashki, Zyra Arsimore, Drejtoria e Arsimit |
| 2.1.3 Rritja e numrit të romëve dhe egjiptianëve (gra dhe burra) që punojnë si edukatorë në arsimin parashkollor dhe si mësues në arsimin e detyrueshëm | Zyra e Arsimit / Bashkia | Numri i romëve dhe egjiptianëve që punojnë si edukatorë në arsimin parashkollor dhe si mësues.<br><br>Të dhëna të disagreguara: F/M, etnicitetit. | Raport i paraqitur nga Zyra e Arsimit/ Bashkia | Çdo 6-mujor | 4,320,000 | Drejtoria e Shërbimit Social (DSHS) në Bashki |
| 2.1.4 Krijimi i pozicioneve ndihmëse për romët dhe egjiptianët në arsimin parashkollor dhe atë bazë (për ndihmë për detyrat e shtëpisë dhe studimin në klasat e ulta, 1-4) | Zyra e Arsimit / Bashkia | Numri i vajzave dhe djemve romë dhe egjiptianë që përfitojnë nga mbështetja në kryerjen e detyrave të shtëpisë dhe gjatë studimit.<br><br>Të dhëna të disagreguara: F/M, etnicitetit, qytet/fshat | Raport i paraqitur nga Zyra e Arsimit/ Bashkia | Çdo 6-mujor | 4,320,000 | Drejtoria e Shërbimit Social (DSHS), Zyra e Arsimit, Drejtoria Arsimore. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1.5 Sigurimi i transportit falas për në shkollë dhe kopshte i fëmijëve romë dhe egjiptianë që i kanë shkol-lat/ kopshtet larg (edhe nën 2 km) për arsye sigurie të justifikuara | DAR/ Zyra e Arsimit Bashkia | Numri i djemve dhe vajzave rome dhe egjiptiane që përfitojnë trans-port falas për në shkollë<br><br>Të dhëna të disagreguara: F/M; grup-mosha; etnicitetit; qytet/fshat | Raportet e DAR/Zyra Arsimit në Bashki | Çdo vit (2019-2022) | 3,920,000 | DAR/Zyra e Arsimit Bashkia |
| 2.1.6 Dhënia e bonusit nga Bashkia për familjet me fëmije që frekue-ntojnë klasat nga 6-9 me qëllim përfundimin e arsimit të detyrueshëm. | DAR/ Zyra e Arsimit Bashkia | Numri i nxënësve dhe studentëve romë dhe egjiptianë përfitues, F/M, | Raportim i Zyrës së Arsimit në Bashki | Çdo vit (2019-2022) | 3,132,000 | DAR/Zyra e Arsimit Bashkia |
| 2.1.7 Krijimi i një sistemi dhe in-frastrukturës për mensat e shkol-lave që frekuen-tohen nga fëmijë romë dhe egjip-tianë në mënyrë që të konsumo-hen vakte ush-qimi për të gjithë fëmijët | DAR/ Zyra e Arsimit Bashkia | Shtim buxheti për mbështetjen e fëmijëve që ndjekin arsimin 9 vjeçar falas në shkollë | Raportim i Zyrës së Arsimit në Bashki | Çdo vit (2019-2022) | 35,640,000 | DAR/Zyra e Arsimit Bashkia |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.1.8 Regjistrimi i personave madhorë dhe prindërve romë dhe egjiptianë që iu mungojnë aftësitë e shkrimit dhe leximit dhe nuk kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm në Programin e Arsimit Bazë me Kohë të Pjesshme. | DAR/ Zyra e Arsimit Bashkia | Numri i personave të moshës mbi 16 vjeç që regjistrohen në programin e arsimit bazë me kohë të pjesshme<br><br>(F/M, etniciteti) | Raportim i Zyrës së Arsimit në Bashki | Çdo vit (2019-2022) | 1,593,000 | DAR/Zyra e Arsimit Bashkia |
| 2.1.9 Organizimi i aktiviteteve ndërkulturore jashtëshkollore për ndërgjegjësimin rreth identitetit rom dhe atij egjiptian. | Bashkia/ Zyra Arsimore/ DAR | Numri i aktiviteteve ndërkulturore<br><br>Numri indikativ i nxënësve pjesëmarrës | Raportim i Zyrës së Arsimit në Bashki | Çdo vit (2019-2022) | 3,000,000 | Zyra e Arsimit, Bashki/Drejtoria Arsmore Elbasan |
| 2.1.10 Parandalimi dhe trajtimi i shkollave të segreguara | Drejtoria Arsimore Elbasan/ Zyra e Arsimit Bashki | Numri i shkollave të segreguara.<br><br>Numri i klasave të segreguara.<br><br>Ndarja sipas: qytet/fshat | MAS/ Komisioneri për Mbrojtje nga Diskriminimi (KMD) | Çdo vit (2019-2022) | 1,478,400 | Zyra e Arsimit Bashki/ Drejtoria Arsimore |

| Fusha e ndërhyrjes: Arsimi dhe Promovimi i Dialogut Ndërkulturor | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Masa/Aktiviteti | Aktorët | Treguesit e rezultateve | Burimet e të dhënave | Afatet | Fondet/ Financimi | Monitorimi |
| Objektivi specifik 2.2: Të forcohet bashkëveprimi i shkollës me shërbimet sociale, për adresimin e rasteve të fëmijëve romë dhe egjiptianë me probleme sociale-ekonomike.<br><br>Treguesi: Përqindja e vajzave dhe djemve të pakicave rome dhe egjiptiane me probleme social-ekonomike, që do të gjejnë mbeshtetje nga shërbimet sociale si rezultat i koordinimit me institucionet arsimore komunitare. | | | | | | |
| 2.2.1 Identifikimi dhe regjistrimi i të gjithë vajzave dhe djemve romë dhe egjiptianë në moshë të detyrueshme shkollore në shkollë, nëpërmjet grupeve shumë-sektoriale të punës në nivel vendor. | Zyra Arsimore dhe DSHS/Bashki, qendrat shëndetësore/policia | Numri i vajzave dhe djemve romë dhe egjiptianë të regjistruar çdo vit në arsimin fillor<br><br>(M/F, etnicitetit, qytet/fshat). | Raport i paraqitur nga DSHS/Zyra e Arsimit Elbasan | Çdo vit (2019-2022) | 739,200 | Drejtoria e Shërbimit Social (DSHS) në Bashki, Administratorët e lagjeve dhe NJA, Drejtoria Arsimore në Elbasan |
| 2.2.2 Përditësimi i bazës së të dhënave për fëmijët në moshën për arsimin parashkollor dhe arsimin e detyrueshëm (përfshirë romët dhe egjiptianët) | Zyra Arsimore / Bashkia / DSHS | Baza e të dhënave e përditësuar | Raport i paraqitur nga DSHS | Rregulisht (raportim çdo 6-mujor) | 616,000 | Drejtoria e Shërbimit Social (DSHS) në Bashki, Zyra Arsimore, Drejtoria e Arsimit |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.2.3 Ndjekja me çdo shkollë e identifikimit të vajzave dhe djemve romë dhe egjiptianë, që mungojnë në sistemin e arsimit parashkollor dhe atë të detyrueshëm për të siguruar regjistrimin e tyre | Zyra e Arsimit / Bashkia | Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë të identifikuar që mungojnë në sistemin e arsimit parashkollor dhe në atë të detyrueshëm<br><br>(F/M, etniciteti) | ROMALB/Raport i paraqitur nga Zyra e Arsimit/ Bashkia | Çdo 3-mujor | 492,800 | Drejtoria e Shërbimit Social (DSHS) në Bashki |
| 2.2.4 Organizimi i takimeve periodike me prindër romë dhe egjiptianë në vendbanimet e tyre për çështje që lidhen me rëndësinë e arsimit të detyrueshëm. | Drejtoria Arsimore, Zyra e Arsimit / Bashkia | Numri i vizitave derë më derë të kryera nga psikologu, punonjësi social ose nga mësuesit ndihmës<br><br>Numri i prindërve romë dhe egjiptianë pjesëmarrës në fushatat ndërgjegjësuese | Raport i shkollave/Drejtoria Arsimore në Elbasan/ Bashkia | Çdo vit (2019-2022) | 739,200 | Drejtoria e Shërbimit Social (DSHS) / Zyra e Arsimit, Drejtoria Arsimore. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.2.5 Referimi i familjeve të fëmijëve që braktisin shkollën ose që rrezikojnë të braktisin arsimin e detyrueshëm, në shërbimet e mbrojtjes sociale dhe burimet e tjera të mbështetjes. | Drejtoria Arsimore/ Zyra e Arsimit Bashki / Bordet e prindërve në çdo shkollë | Numri i familjeve të referuara në shërbimet e mbrojtjes sociale ose në burimet e tjera të mbështetjes për fëmijët që braktisin shkollën.<br><br>(F/M, Ndarja sipas: etnicitetit, qytet/fshat) | Raporti i Drejtorisë Arsimore / Zyra Arsimit në Bashki | Çdo vit (2019-2022) | 369,600 | Drejtoria Arsimore/Zyra e Arsimit në Bashki |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Objektivi specifik2.3: Përmirësimi i rezultateve në mësime të fëmjëve romë dhe egjiptianë<br>Treguesi: Rritja me 20% e notës mesatare të nxënësve romë dhe egjiptianë, që përfundojnë arsimin e detyrueshëm. | | | | | | |
| 2.3.1 Ngritja e ekipit të vijueshmërisë dhe ndihmesës në çdo shkollë për fëmijët romë dhe egjiptianë (drejtor shkolle, mësues kujdestar, psikolog, punonjës social, ndërmjetësues komuniteti) për të ndihmuar në përmirësimin e rezultateve në shkollë. | Drejtoria Arsimore, Shkollat/ Njësitë Administrative/Zyra e Arsimit në Bashki | Numri i ekipeve të ngritura në shkollat me nxënës romë dhe egjiptianë | Raportim i Zyrës së Arsimit në Bashki | Çdo vit (2019-2022) | 739,200 | DAR/Zyra e Arsimit në Bashki |
| 2.3.2 Promovimi i rasteve të suksesshme të nxënësve më të mirë romë dhe egjiptianë | Shkolla, Drejtoria Arsimore, Zyra e Arsimit në Bashki | Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë të promovuar. | Raportim i Zyrës së Arsimit në Bashki | Çdo vit (2019-2022) | 1,200,000 | Drejtoria Arsimore, Zyra e Arsimit në Bashki |
| Objektivi specifik2.4: Përmirësimi i dialogut ndërkulturor dhe mirëkuptimit të përbashkët | | | | | | |
| 2.4.1 Organizimi i javës së kulturës rome (2-8 Prill) dhe kthimi në një traditë të përvitshme, 24 Qershor për ditën e egjiptianëve, si dhe aktiviteteve gjatë vitit. | Bashkia/ Drejtoria e Politikave Strategjike Inovacionit dhe Medias, DAR, Shkollat, qendra komunitare | Numri indikativ i pjesëmarrësve në eventet / aktivitetet e kryera | Raportim i Bashkisë | Çdo vit (2019-2022) | 3,200,000 | Bashkia / DSHS/DAR |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.4.2 Aktivitete për promovimin e identitetit, vlerave kulturore të pakicave rome dhe egjiptiane[47] | Bashkia / Drejtoria e Politikave Strategjike Inovacionit dhe Medias, DSHS, Media vendore, OSHC, qendra komunitare | Numri i evenimenteve / aktiviteteve dhe qëllimi i tyre<br><br>Numri indikativ i pjesëmarresve në çdo aktivitet | Raportim i Bashkisë / Publikime në website, OSHC, projekte të donatorëve | Çdo vit (2019-2022) | 400,000 | Raporti vjetor i grupit të monitorimit të Planit të Veprimit |
| 2.4.3 Promovimi i talenteve në art (këngë dhe instrumente muzikore), zeje në aktivitete social-kulturore. | Bashkia/ Qendra sociale komunitare mediet vendore/ DAR | Numri i femijeve të identifikuar si talente në aktivitetet e kryera<br><br>Numri i fëmijëve të promovuar në mediet vendore | Bashkia / Qendra Sociale / Mediet | Çdo vit (2019-2022) | 3,000,000 | Raporti vjetor i grupit të monitorimit të Planit të Veprimit |
| 2.4.4 Ngritja e një platforme bashkëpunimi dhe koordinimi midis organizatave të shoqërisë civile, Bashkisë dhe donatorëve dhe aktorëve të tjerë vendorë që promovojnë dialogun ndërkulturor | Bashkia | Numri i aktiviteteve<br><br>Numri indikativ i pjesëmarrësve | Bashkia / OSHC / donatorë | Çdo vit (2019-2022) | 1,232,000 | Raporti vjetor i grupit të monitorimit të Planit të Veprimit |

47 Aktivitete në datën 1 Qershor-dita ndërkombëtare e fëmijëve, 17 Tetor – dita botërore kundër varfërisë, 10 Dhjetor-Dita botërore e tolerancës

| Masa/Aktiviteti | Aktorët | Treguesit e rezultateve | Burimet e të dhënave | Afatet | Fondet/ Financimi | Monitorimi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Fusha e ndërhyrjes: Kujdesi Shëndetësor<br>Qëllimi strategjik 3: Rritja e jetëgjatësisë dhe ulja e sëmundshmërisë ndër pakicat rome dhe egjiptiane | | | | | | |
| Objektivi specifik 3.1: Rritja e aksesit të pakicave rome dhe egjiptiane në shërbimet e kujdesit shëndetësor<br>Treguesi 1: % e anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane që do të kenë mundësi të përdorin shërbimet bazë shëndetësore deri në fund të vitit 2020. | | | | | | |
| 3.1.1 Kontrolle periodike në terren dhe informim i pakicave rome dhe egjiptiane mbi kontrollin shëndetësor bazë, shërbimin falas dhe kontrollin periodik (check-up) | NJVKSHE / Qendra Shëndetësore | Numri i personave romë dhe egjiptianë të vizituar në vitin e raportimit<br>Numri i të sëmurëve kronikë romë dhe egjiptianë<br>Numri i personave romë dhe egjiptianë, që kanë bërë check up. | Raport i paraqitur nga DSH Publik / Bashkia | Çdo vit (2019-2022) | 443,520 | NJVKSHE / Qendra Shëndetësore/ Bashkia |
| 3.1.2 Depistim çdo vit i zonave ku jetojnë familjet rome dhe egjiptiane për identifikimin e fëmijëve të pavaksinuar | NJVKSHE / Qendra Shëndetësore | Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë, që kanë bërë vaksinat në vitin e raportimit (F/M).<br>Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë, që kanë bërë vaksinat përkundrejt numrit të përgjithshëm të fëmijëve. | Raport i paraqitur nga DSHS | Çdo vit (2019-2022) | 369,600 | NJVKSHE / Qendra Shëndetësore/ Bashkia |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3.1.3 Krijimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave për sëmundshmërinë e romëve dhe egjiptianëve | Qendra Shëndetësore | Evidenca për sëmundshmërinë e anëtarëvë të pakicav R&E | Raportim nga Qendra Shëndetësore | Çdo vit (2019-2022) | 492,800 | NJVKSHE / Qendra Shëndetësore/ Bashkia |
| 3.1.4 Evidentimi i romëve dhe egjiptianëve pa kartë shëndeti dhe ofrimi i mbështetjes për paisjen me kartë shëndeti | Qendra Shëndetësore / Qendra komunitare / DRAKPA | Numri i personave R&E të identifikuar me mungesë të kartës së identitetit.<br>Numri i personave të paisur me kartë shëndeti.<br>% e R&E të paisur me kartë shëndeti në raport me numrin e anëtarëve të komuniteteve që jetojnë në bashki | Qendra Shëndetësore / Qendra komunitare /DRAKPA | Çdo vit (2019-2022) | 295,680 | NJVKSHE / Qendra Shëndetësore/ Bashkia / Raporti vjetor i grupit të monitorimit |
| 3.1.5 Informim dhe ndërgjegjësim të familjeve rome për të vaksinuar fëmijët e tyre | Qendra Shëndetësore / Qendra komunitare / Bashkia | Numri i personave romë dhe egjiptianë të informuar | Qendra Shëndetësore / Qendra komunitare/ Bashkia | Çdo vit (2019-2022) | 492,800 | NJVKSHE / Qendra Shëndetësore/ Bashkia / Raporti vjetor i grupit të monitorimit |
| 3.1.6 Nxitja e katedrave universitare mjekësore që të ndërmarrin punë në terren në ndihmë të pakicave rome dhe egjiptiane (ekipe mjekësore dhe studentë të mjekësisë për të ofruar vizita falas) | Bashkia, DSHP | Numri i nismave<br>Numri ipersonave të vizituar dhe këshilluar | Raportim nga DSHP / Bashkia | 2019-2020 | 3,000,000 | DSHP / Qendra Shëndetësore/ Bashkia / Raporti vjetor i grupit të monitorimit |

| Objektivi 3.2: Përmirësimi i informimit dhe promocionit shëndetësor për shërbimet e disponueshme të kujdesit shëndetësor për romët dhe egjiptianët.<br><br><u>Treguesi i objektivit</u>: Përqindja e anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane, që do të kenë informacion të plotë në lidhje me çështjet që ndikojnë në shëndetin e tyre si dhe shërbimet e disponueshme të kujdesit shëndetësor. | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3.2.1 Sigurimi i diagnostikimit bazë dhe ndihma e parë nëpërmjet ekipeve mjekësore të lëvizshme për romët dhe egjiptianët, të cilët nuk mbulohen nga sistemi bazë (që nuk kanë dokumente personale/vërtetimi i banimit ose sigurimi shëndetësor) | DSHP / Qendra komunitare / ndërmjetës | Numri i romëve dhe egjiptianëve që marrin informacion (përfshirë atë për çështje fizike, mendore dhe të shëndetit riprodhues, SST-të, vaksinimin e fëmijëve 0-14 vjeç, përdorimit të drogës etj.) dhe shërbime nga ekipet mjekësore të lëvizshme.<br><br>Ndarja F/M, grupmoshës, etnicitetit; qytet/fshat<br><br>Numri i vizitave në vendbanimet e pakicave rome dhe egjiptiane. | Raportim nga DSHP / Qendra komunitare / Bashkia | Çdo vit (2019-2022) | 1,800,000 | DSHP / Qendra Shëndetësore/ Bashkia / Raporti vjetor i grupit të monitorimit |
| 3.2.2 Organizimi i sesioneve informuese mbi strukturat shëndetësore dhe shërbimet që ofrohen | DSHP / Qendra komunitare / ndërmjetës | Numri I takimeve në komunitet<br><br>Numri indikativ i anëtarëve pjesëmarrës. | Raportim nga DSHP / Qendra komunitare / Bashkia | Çdo vit (2019-2022) | 184,800 | DSHP / Qendra Shëndetësore/ Bashkia / Raporti vjetor i grupit të monitorimit |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3.2.3 Rekrutimi dhe trajnimi i romëve dhe egjiptianëve si ndërmjetësues për shtrirjen e shërbimeve shëndetësore. | DSHP / Qendra komunitare / ndërmjetës | Numri i romëve dhe egjiptianëve të rekrutuar dhe të trajnuar si ndërmjetësues | Raportim nga DSHP / Qendra komunitare / Bashkia | Çdo vit (2019-2022) | 1,396,800 | DSHP / Qendra Shëndetësore/ Bashkia / Raporti vjetor i grupit të monitorimit |
| 3.2.4 Përgatitja e informacioneve të thjeshta dhe materialeve promocionale për çështjet shëndetësore, edhe në gjuhën rome dhe me figura | DSHP / Qendra komunitare / ndërmjetës | Numri i materialeve promocionale i përgatitur në gjuhën rome dhe/ose përfshirë figurat (ilustrime) | Materialet promocionale | Çdo vit (2019-2022) | 900,000 | DSHP / Qendra Shëndetësore/ Bashkia / Raporti vjetor i grupit të monitorimit |
| 3.2.5 Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese mbi punët me rrezik për shëndetin dhe masat parandaluese për pakicat rome dhe egjiptiane të përfshira në punë informale. | DSHP / Qendra komunitare / ndërmjetës | Studimi i përgatitur | Raportim nga DSHP / Qendra komunitare / Bashkia | 2019-2022 | 960,000 | DSHP / Qendra Shëndetësore/ Bashkia / Raporti vjetor i grupit të monitorimit |

| Fusha e ndërhyrjes: Punësimi e Formimi Profesional (AFP)<br><br>Qëllimi strategjik 4: Krijimi i mundësive të barabarta për punësimin formal të romëve dhe egjiptianëve. | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Masa/Aktiviteti | Aktorët | Treguesit e rezultateve | Burimet e të dhënave | Afatet | Fondet/ Financimi | Monitorimi |
| Objektivi specifik 4.1: Rritja e aksesit të romëve dhe egjiptianëve në formimin profesional dhe në programe të nxitjes së punësimit.<br><br>Treguesi: Rritja në përqindje e grave dhe burrave romë dhe egjiptianë, të cilët marrin pjesë në AFP dhe programet aktive të punësimit do të integrohen në tregun e punës deri në fund te vitit 2022 | | | | | | |
| 4.1.1 Mbështetja e pjesëmarrjes së romëve dhe egjiptianëve në programet e nxitjes së punësimit (PNP), dhe Bashkia në bashkëpunim më Zyrën e Punës | DRAKPA / Bashkia/ DSHS/ Drejtoria e Politikave Strategjike Inovacionit dhe Medias,<br><br>Dhoma e Tregtisë | Numri i romëve dhe egjiptianëve (meshkuj dhe femra) që përfshihen në PNP (sipas programit dhe si përqindje e të gjithë pjesëmarrësve),<br><br>Numri i personave që punësohen dhe numri i personave që arrijnë të vazhdojnë të jenë të punësuar pas përfundimit të programit.<br><br>(Punëkërkues pu.pa, F/M, sipas grup-moshës, të punësuar nëpërmjet zyrave të punësimit. | Raportim i Zyrës së Punës | Çdo vit (2019-2022) | 9,430,000 | DRAKPA / Bashkia / DSHS, Raporti vjetor i grupit të monitorimit |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.1.2 Kryerja e punëve komunitare (Program nxitje punësimi) | DRAKPA / Bashkia/ DSHS/ Drejtoria e Politikave Strategjike Inovacionit dhe Medias,<br>Dhoma e Tregtisë | Numri i punëve komunitare të kryera | Raportim i Zyrës së Punës / Bashkia | Çdo vit (2019-2022) | 4,500,000 | DRAKPA / Bashkia / DSHS, Raporti vjetor i grupit të monitorimit |
| 4.1.3 Pjesëmarrja falas e romëve dhe egjiptianëve në formimin profesional publik, në kurse të profesioneve të kërkuara në tregun e punës | DRAKPA / Bashkia/ DSHS/ Drejtoria e Politikave Strategjike Inovacionit dhe Medias, Qendra Rajonale e Formimit Profesional | Numri i romëve dhe egjiptianëve (F/M), të cilët përfundojnë kurset e formimit profesional.<br>(F/M, grupmosha; etniciteti; qytet/fshat)<br>Numri i romëve dhe egjiptianëve (M/F), të cilët përfundojnë kurset e formimit profesional dhe që arrijnë të punësohen ose vetpunësohen.<br>(M/F), etniciteti; qytet/fshat | Raportim i Zyrës së Punës / Bashkia | Çdo vit (2019-2022) | 2,160,000 | DRAKPA / Bashkia / DSHS, Raporti vjetor i grupit të monitorimit |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.1.4 Trajnime dhe këshillime për zhvillimin e aftësive të jetës me fokus të rinjtë romë dhe egjiptianë në qendrën komunitare | DSHS, Zyra Arsimore, Qendra komunitare | Numri i personave të këshilluar (të paktën 1 trajnim/këshillim i organizuar) në vit | Raportim nga qendra komunitare/DSHS (Bashkia) | Çdo vit (2019-2022) | 600,000 | DRAKPA / Bashkia / DSHS, Raporti vjetor i grupit të monitorimit |
| 4.1.5 Promovimi i rasteve të suksesshme të romëve dhe egjiptianëve të punësuar nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit. | Bashkia/ DSHS / Qendra komunitare/ DRAKPA/ Mediat | Numri i rasteve të promovuara | Raportim nga qendra komunitare/DSHS (Bashkia) | Çdo vit (2019-2022) | 308,000 | Bashkia/ DRAKPA/ Raporti vjetor i grupit të monitorimit |

| Objektivi 4.2: Krijimi i vendeve të reja të punës<br>Treguesi i objektivit: Rritje në përqindje e numrit të personave romë dhe egjiptianë të punësuar çdo vit deri më 2022 | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.2.1 Vëmendje dhe prioritizim i punësimit të romëve dhe egjiptianëve aplikues për pozicione vakante në administratë dhe shërbime të bashkisë, sipas kritereve të shpalluara dhe kuadrit ligjor. | Këshilli Bashkiak / DSHS | Vendosja e kuotave dhe rritje me 5% e numrit të personave të punësuar çdo vit për periudhën e zbatimit të Planit të Veprimit | Bashkia / DSHS / Drejtoria e Burimeve Njerëzore (DBNJ) | Çdo vit (2019-2022) | Nuk ka kosto shtesë | Bashkia/ DSHS/ DBNJ |
| 4.2.2 Krijimi i programit të punëve në komunitet – investime publike duke përfshirë përfitues nga skema e NE, si dhe romë dhe egjiptianë | Bashkia / Drejtoria e Programimit dhe Zhvillimit/DSHS/ Donatorë/ Sektori Privat | Numri i romëve dhe egjiptianëve të përfshirë në punët në komunitet | Bashkia / DSHS | Çdo vit (2019-2022) | 6,000,000 | Bashkia/ DSHS/ DBNJ |

| Fusha e ndërhyrjes: Punësimi e Formimi Profesional (AFP)<br>Qëllimi strategjik 4: Krijimi i mundësive të barabarta për punësimin formal të romëve dhe egjiptianëve. | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Masa/Aktiviteti | Aktorët | Treguesit e rezultateve | Burimet e të dhënave | Afatet | Fondet/ Financimi | Monitorimi |
| 4.2.3 Ofrimi i granteve të vogla me qëllim nxitjen e punësimit dhe formalizimin e punëve (përfshirë artizanët), me fokus gratë dhe të rinjtë romë dhe egjiptianë | Bashkia,<br>Projekte të donatorëve | Numri i granteve të ofruara<br>Fondi i granteve (në lekë)<br>Numri i romëve dhe egjiptianëve të punësuar / ose formalizuar | Bashkia / Drejtoria e Buxhetit e Financës / DSHS | Çdo vit (2019-2022) | 2,400,000 | Bashkia/ DSHS/ Raporti vjetor i grupit të monitorimit |
| 4.2.4 Lehtësimi e mbështetja e ndërmarrjeve sociale, që synojnë punësimin e romëve dhe egjiptianëve. | Bashkia,<br>Projekte të donatorëve | Numri i ndërmarrjeve sociale ose bizneseve qe jane mbështetur (lehtësuar) nga Bashkia<br>Numri i personave romë dhe egjiptianë të punësuar | Bashkia / Drejtoria e Buxhetit e Financës / DSHS | Çdo vit (2019-2022) | 3,000,000 | Bashkia/ DSHS/ Raporti vjetor i grupit të monitorimit |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.2.5 Hapja e një tregu publik për tregtimin e rrobave të për-dorura | Bashkia, Drejtoria e Aseteve, DSHS | Sipërfaqja dhe kapaciteti i tre-gut<br><br>Numri i R&E për-fitues | Bashkia | 2020 | -5,000,000 | Bashkia/ DSHS/ Raporti vjetor i grupit të monitori-mit |
| 4.2.6 Promovimi i shembujve pozi-tivë të punësimit të romëve dhe egjiptianëve | Bashkia / DSHS / | Numri i perso-nave te prom-ovuar | Bashkia / DSHS | 2019-2022 | 308,000 | Bashkia/ DSHS/ Raporti vjetor i grupit të monitori-mit |

| Fusha e ndërhyrjes: Strehimi dhe integrimi urban<br>Qëllimi strategjik 5: Përmirësimi i kushteve të banimit dhe infrastrukturës urbane të zonave të banimit të romëve dhe egjiptianëve | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Masa/Aktiviteti | Aktorët | Treguesit e rezultateve | Burimet e të dhënave | Afatet | Fondet/Financimi | Monitorimi |
| Objektivi specifik 5.1: Rritja e aksesit të romëve dhe egjiptianëve në programe të strehimit social<br>Treguesi: Rritja në përqindje e familjeve që jetojnë në kushte të përmirësuara banimi. | | | | | | |
| 5.1.1 Ofrimi i ndihmës nga Bashkia për familjet rome dhe egjiptiane për përmirësimin e kushteve të banesave nëpërmjet aplikimeve çdo vit për financim nga programet e strehimit social | Bashkia/ Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Urban / DSHS/ Drejtoria e Aseteve, Pronave dhe Strehimit. | Numri i projekteve / aplikimeve të përgatitura çdo vit nga Bashkia<br>Numri i projekteve të miratuara për financim nga MFE | Raportim i Bashkisë/ Drejtoria e Zhvillimit Urban/DSHS | Çdo vit (2019-2022) | 1,232,000 | Bashkia / DSHS, Raporti vjetor i grupit të monitorimit |
| 5.1.2 Dhënia e granteve të vogla për përmirësimin e kushteve të banesave të romëve dhe egjiptianëve (si dhe pajisjet hidrosanitare ose ndërtimet e reja) në zonën e Rrapishtës dhe zona pranë stadiumit, Bradashesh, dhe zonat të tjera. | Bashkia/ Drejtoria e Aseteve, Pronave dhe Strehimit. | Numri i granteve<br>Fondi në lekë<br>Numri i banesave të përmirësuara | Raportim nga Bashkia / DSHS | Çdo vit (2019-2022 | 14,000,000 | Bashkia / DSHS, Raporti vjetor i grupit të monitorimit |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5.1.3 Planifikimi dhe kryerja e investimeve për përmirësimin e infrastrukturës urbane (sistemi i furnizimit me ujë, rrugë dhe trotuarë, sistemi i mbledhjes së mbetjeve urbane) - | Bashkia / Drejtoria e Planifikimit e Zhvillimit Urban / Drejtoria e Buxhetit/ Financës/ DSHS/Drejtoria e Aseteve, Pronave dhe Strehimit. | Numri i projekteve për ndërhyrje dhe përmirësim të infrastrukturës urbane të zonave të banimit me përqendrim të romëve dhe egjiptianëve<br>Fondi i investimit në lekë<br>Numri i familjeve me impakt pozitiv (përfituese) | Drejtoria e Zhvillimit Urban/DSHS | Çdo vit (2019-2022) | 160,000,000 | Bashkia / DSHS, Raporti vjetor i grupit të monitorimit |
| 5.1.4 Fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi rreth programeve të strehimit social dhe mënyrat e aplikimit për romët dhe egjiptianët | Bashkia / DSHS/ Drejtoria e Aseteve, Pronave dhe Strehimit | Numri i takimeve informuese<br>Numri i personave romë dhe egjiptianë të informuar | Raportim i Bashkisë | Çdo vit (2019-2022) | 500,400 | Bashkia / DSHS / Sektori i strehimit, Raporti vjetor i grupit të monitorimit |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5.1.5 Ofrim asistence për plotësimin e dokumentacionit në programet e strehimit social (dhe bonus qeraje) | Bashkia / DSHS / Drejtoria e Aseteve, Pronave dhe Strehimit | Numri i personave romë dhe egjiptianë të mbështetur | Raportim i Bashkisë | Çdo vit (2019-2022) | 1,000,800 | Bashkia / DSHS / Sektori i strehimit, Raporti vjetor i grupit të monitorimit |
| 5.1.6 Krijimi i një baze të dhënash (sistemi) për regjistrimin/përditësimin e të dhënave lidhur me kushtet e banimit dhe nevojat për strehim, listën e të pastrehëve romë dhe egjiptianë | Bashkia / DSHS / Drejtoria e Aseteve, Pronave dhe Strehimit | Baze të dhënash e krijuar | Raportim i Bashkisë | Çdo vit (2019-2022) | 266,880 | Bashkia / DSHS / Sektori i strehimit, Raporti vjetor i grupit të monitorimit |
| 5.1.7 Ndërtimi i banesave sociale | Qeveria / Bashkia / Drejtoria e Aseteve, Pronave dhe Strehimit. | Numri i banesave sociale të ndërtuara<br>Numri i familjeve rome dhe egjiptiane përfituese | Raportim Bashkisë | 2022 | 110,000,000 | Bashkia / DSHS |
| 5.1.8 Ofrimi i ndihmës për familjet rome dhe egjiptiane që nuk kanë mundësi të paguajnë qeranë e strehimit social përfshirë referimin për punësimin dhe shërbimet e tjera përkatëse | Bashkia | Numri I familjeve përfituese nga pagesat e bonos së strehimit | Raportim Bashkisë | Çdo vit (2019-2022) | 12,600,000 | Bashkia / DSHS |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5.1.9 Fuqizimi i mekanizmave konsultues me pakicat rome dhe egjiptiane mbi çështjet e përmirësimit të infrastrukturës urbane | Bashkia / Drejtoria e Planifikimi dhe Zhvillimit Urban / DSHS / Drejtoria e Aseteve, Pronave dhe Strehimit | Numri I takime-ve konsultuese me komu-nitetet | Raportim Bashkisë | Çdo vit (2019-2022) | 500,400 | Bashkia / DSHS |
| 5.1.10 Hartëzimi i vendbani-meve me përqendrim të lartë të pakicave rome dhe egjip-tiane dhe përgatitja e fishë-projekteve sipas prioritizimit të tyre nga Bashkia | Bashkia / Drejtoria e Planifikimi dhe Zhvillimit Urban / DSHS / Drejtoria e Aseteve, Pronave dhe Strehimit | Harta e vend-banimeve dhe identifikimi i nevojave i kryer.<br>Fishat e projekt-investimeve përgatitur dhe miratuar. | Raportim Bashkisë | Çdo vit (2019-2022) | 889,600 | Bashkia / Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvil-limit Urban / DSHS |

| Fusha e ndërhyrjes: Mbrojtja Sociale<br>Qëllimi strategjik 6: Përmirësimi i përfshirjes së anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane në programet e mbrojtjes sociale | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Masa/Aktiviteti | Aktorët | Treguesit e rezultateve | Burimet e të dhënave | Afatet | Fondet/ Financimi | Monitorimi |
| Objektivi specifik 6.1: Rritja e aksesit të pakicave rome dhe egjiptiane në programet e mbrojtjes sociale<br>Treguesi: Rritja në përqindje e anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane të përfshirë në programet e mbrojtjes sociale deri në fund të vitit 2022 | | | | | | |
| 6.1.1 Fushata informimi dhe ndërgjegjësimi rreth programeve të mbrojtjes sociale (NE, pensione sociale, pagesë papunësie, pagesë paaftësie) | Bashkia / DSHS | Numri i fushatave<br>Numri i personave romë dhe egjiptianë të informuar | Bashkia / DSHS | Çdo vit (2019-2022 | 667,200 | Bashkia / DSHS, Raporti vjetor i grupit të monitorimit |
| 6.1.2 Ofrimi i mbështetjes në plotësimin e formularëve për ndihmë ekonomike, pensione sociale, pagesë papunësie, pagesë paaftësie) | Bashkia / DSHS | Numri i aplikimeve (rritje me 3-5% të numrit të palikimeve çdo vit) | Raportim i Bashkise/ / DSHS | Çdo vit (2019-2022) | 667,200 | Bashkia / DSHS, Raporti vjetor i grupit të monitorimit |
| 6.1.3 Trajnime të administratorëve socialë lidhur me shërbimet sociale, legjislacionin dhe fusha të tjera relevante | Bashkia / DSHS / Qendra komunitare / MSHCS | Numri i trajnimeve<br>Numri i personave (staf I Bashkisë) të trajnuar | Raportim nga Bashkia / DSHS | Çdo vit (2019-2022 | 140,000 | Bashkia / DSHS, Raporti vjetor i grupit të monitorimit |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6.1.4 Trajnime për përfaqësuesit e zyrave me një ndalesë për adresimin sa më të shpejtë të problematikave të identifikuara nga komuniteti rom në zonat ku ato ofrojnë shërbime | Bashkia / DSHS / Zyra me Një ndalesë / Qendra komuni-tare | Numri i trajni-meve<br>Numri i person-ave (staf i Bash-kisë) të trajnuar | Rapor-tim nga Bashkia / DSHS / Zyra me Një Ndalesë | Çdo vit (2019-2022 | 160,000 | Bashkia / DSHS, Ra-porti vjetor i grupit të monitorimit |
| 6.1.5 Forcimi i ekipeve të lëvizshme (administratorë socialë, lehtësues komuniteti, qendër komunitare) për të identifikuar, vlerësuar/adresuar nevojat social-ekonomike të familjeve /individëve romë dhe egjiptianë | Bashkia / DSHS | Raport vlerësimi | Rapor-tim nga Bashkia / DSHS | Çdo vit (2019-2022) | 750,600 | Bashkia / DSHS, Ra-porti vjetor i grupit të monitorimit |
| 6.1.6 "Shporta për Ju", e cila përmban produkte ushqimore bazë (jetike) dhe është e barazvlereshme me masen e NE, nismë në bashkëpunim me aktorë të tjerë për ndihmesë familjeve rome dhe egjiptiane, që nuk janë shpallur përfitues nga skema e NE | Bashkia / DSHS / Biznese / | Numri i familjeve / individë të asis-tuar | Raportim i Bashkisë | Çdo vit (2019-2022) | 1,045,000 | Bashkia / DSHS |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6.1.7 Përfshirja e administratorit social dhe Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në ekipet e lëvizshme multidisiplinore kundër trafikimit. | Bashkia / DSHS | Numri i romëve dhe egjiptianëve viktima të trafikimit të qenieve njerëzore që përfitojnë nga programi i mbrojtjes sociale me pagesa në para dhe me shërbime sociale ndaj individit dhe familjes | Raportim i Bashkisë | Çdo vit (2019-2022) | 533,760 | Bashkia / DSHS / Skuadrat e terrenit për monitorim Administratorë të NJA dhe lagjeve |
| 6.1.8 Organizimi i fushatave qytetare/ aktiviteteve sociale solidare "Shporta për Ju" për ndihma ushqimore, veshmbathje për më të varfërit | Bashkia / DSHS | Numri i fushatave Numri i familjeve përfituese | Raportim Bashkisë | Çdo vit (2019-2022) | 800,000 | Bashkia / DSHS |

| Rritja e Pjesëmarrjes të pakicave rome dhe egjiptiane në proceset e vendimmarrjes vendore | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Masa/Aktiviteti | Aktorët | Treguesit e rezultat-eve | Burimet e të dhënave | Afatet | Fondet/ Financimi | Monitorimi |
| Objektivi 7: Rritja e ndërgjegjësimit dhe përfshirjes aktive të pakicave rome dhe egjyptiane në vendimmarrjen vendore | | | | | | |
| 7.1 Organizimi i takimeve paraprake me pakicat rome dhe egjiptiane dhe OSHC-të dhe informimi mbi buxhetin dhe fushat prioritare | Bashkia/Drej-toria e Buxhetit / Drejtoria e Politikave Strategjike, Inovacionit dhe Medias/ Drejto-ria e Shërbimit Social/ | i) Numri i takimeve<br>ii) Numri i anetarëve pjesëmarrës<br>iii) Numri i rekoman-dimeve nga komu-niteti që janë konsid-eruar në planifikimin e buxhetit në raport me numrin total të kërkesave | Raportim i DSHS / Drejto-ria e Buxhetit / Drejtoria e Politikave Strategjike, Inovacionit dhe Medias/ | Çdo vit (2019-2022) | Fond i Bashkise (pa kosto shtesë) | Bashkia / DSHS |
| 7.2. Organizimi i takimeve me pakicat rome dhe egjiptiane mbi zbatimin e buxhetit dhe të projek-teve të planifikuara në fil-lim të vitit për romët dhe egjiptianët mbi nivelin e zbatimit të tyre | Bashkia/Drej-toria e Buxhetit / Drejtoria e Politikave Strategjike, Inovacionit dhe Medias/ Drejto-ria e Shërbimit Social/ | i) Numri i takimeve<br>ii) Numri i anetarëve pjesëmarrës | Raportim nga Bashkia/ DSHC/Drejto-ria e Buxhetit | Çdo vit (2019-2022) | Fond i Bashkise (pa kosto shtesë) | Bashkia / DSHS |

| Koordinimi, Monitorimi dhe Vlerësimi i Planit të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në nivel vendor | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Masa/Aktiviteti | Aktorët | Treguesit e rezultateve | Burimet e të dhënave | Afatet | Fondet/ Financimi | Monitorimi |
| Objektivi 1: Monitorimi i zbatimit të masave dhe treguesve të planit të veprimit me të gjitha institucionet në nivel vendor për të reduktuar pabarazinë social – ekonomike të romëve dhe egjiptianëve dhe për të rritur aksesin në shërbimet publike.<br><br>Treguesi: Publikimi i raportit të progresit çdo vit. | | | | | | |
| 1.1 Krijimi i një baze të dhënash për të mbledhur informacion mbi treguesit e Planit të Veprimit për integrimin e R&E në nivel vendor (perfshire tregues të planit vendor qe nuk përmbahen në sistemin ROMALB) | Bashkia/ Drejtoria e Shërbimit Social | Database i krijuar me treguesit e masave dhe tregues të tjere që nuk përmbahen në sistemin ROMALB. | Raportim i DSHS (Bashkia) | Çdo vit (2019-2022) | Fond i Bashkise (pa kosto shtesë) | Bashkia / DSHS |
| 1.2. Komunikimi me të gjitha institucionet publike dhe aktorë të tjerë në nivel vendor për të siguruar informacion të përditësuar (sasior dhe cilësor) sipas sektorëve prioritarë të Planit te veprimit lidhur me raportimin e progresit / Përditësimi i informacionit në portalin e Bashkisë për aktivitetet, projektet për pakicat rome dhe egjiptiane | Bashkia/ DSHS/ | - | Raportim nga Bashkia/DSHC | Çdo vit (2019-2022) | Fond i Bashkisë (pa kosto shtesë) | Bashkia / DSHS |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.3 Hartimi i raportit të progresit dhe publikimi i tij (online në website të bashkisë) lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në nivel vendor dhe vlerësimin e treguesve. | Bashkia/ Grupi i Pu-nës/DSHS/ | Raporti i progresit publikuar<br><br>Numri i kopjeve të shpërnda-ra/ lexuara/ referua | Raporti i Progresit / seti i treg-uesve perd-itesuar | Çdo Janar (2020-2022) | Fond i Bashkisë | Bashkia / DSHS, Ra-porti vjetor i grupit të monitorimit dhe ekspert i jashtëm |
| 1.4 Organizimi i takimeve (të paktën) çdo gjashtë muaj me lehtësuesit për pakicat R&E dhe OSHC-të për të dhënë përditësime për zbatimin e Planit të Veprimit dhe për të adresuar çështje kritike | Bashkia/ Grupi i pu-nës/DSHS/ qendra ko-munitare/ lehtësuesit (pikat e kontaktit) | Numri i takimeve, list-prezen-ca, agjenda e takimeve | Evidenca të takimeve | Çdo 6-mujor (2019-2022) | Fond i Bashkisë (pa kosto shtesë) | Bashkia / DSHS / qendra ko-munitare/ lehtësuesi |
| 1.5 Përditësimi i sistemit të monitorimit dhe raportimit online (ROMALB) me të dhëna të reja nga përdoruesit në nivele të ndryshme | Bashkia/ DSHS (koordi-natori për sistemin ROMALB) | Seti i treg-uesve për-ditësuar | Treguesit e përditësuar | Çdo vit (2019-2022) | Fond i Bashkisë (pa kosto shtesë) | Bashkia / DSHS |

# VIII. Burime Financiare

Ky kapitull trajton në mënyrë të përmbledhur burimet financiare, të nevojshme për zbatimin e "Planit Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022" për Bashkinë Elbasan.

Kostimi i planit të veprimit u realizua mbështetur në informacionet e ofruara nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe të gjitha Drejtoritë e përfshira në zbatimin e këtij plani veprimi. Për kostimin e planit të veprimit u përdor një metodologji e kombinuar, pasi plani përfshin disa sektorë dhe për një pjesë të aktiviteteve janë përgjegjëse institucione të tjera. Metodologjia kryesore e përdorur është kostimi i bazuar në aktivitete. Kostimi u realizua duke u mbështetur në koston e secilit aktivitet të pasqyruar në planin e veprimit. Në llogaritjen e shpenzimeve të përgjithshme u mbajt në konsideratë kohështrirja e masës, numri i aktiviteteve që do të realizohen, numri i përfituesve për aktivitete të caktuara, etj. Në disa raste u përdor dhe vlerësimi për analogji, sidomos në projektet e infrastrukturës dhe strehimit social, i cili merr në konsideratë shpenzimet e bëra për aktivitete të ngjashme. Për aktivitetet që planifikohen të mbulohen nga buxheti i qeverisë qëndore u mbajtën në konsideratë kostot për njësi sipas PBA 2019-2021. Kostimi i Planit të Veprimit u realizua gjithashtu bazuar në praktikën e planifikimit buxhetor dhe metodologjinë e hartimit të buxhetit afatmesëm.

Kostoja e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e masave, nga të gjitha burimet e financimit, është rreth 456.6 milionë lekë ose afërsisht 3.65 milionë euro[48]. Shpërndarja e fondeve për periudhën 2019-2022 u programua duke mbajtur në konsideratë tavanet e projektbuxhetit afatmesëm (PBA 2020-2022). Burimet financiare nga buxheti i shtetit mbulojnë rreth 13.9% të kostos së planit të veprimit, përkatësisht rreth 63.3 milionë lekë. Ndërsa burimet e financimit të angazhuara nga bashkia mbulojnë 41.8% të kostos së planit të veprimit ose 190.9 milionë lekë.

Tabela 9 paraqet buxhetin në vite sipas fushave. 66.5% e shpenzimeve nevojiten për "Strehimin dhe integrimin urban", ndërsa 14.4% për fushën e "Arsimit dhe promovimit të dialogut ndërkulturor".

48 Kursi këmbimit 1Euro=125 lekë

*Tabela 9. Buxheti sipas objektivave strategjik për periudhën 2019-2022*

| Përshkrimi | Buxheti 2019-2022 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| OBJEKTIVAT | Viti 2019 | Viti 2020 | Viti 2021 | Viti 2022 | TOTALI |
| Aksesi Barabartë në Regjistrimin Civil dhe në Drejtësi | 7,473,320.00 | 7,571,720.00 | 7,159,520.00 | 7,011,920.00 | 29,216,480.00 |
| Arsimi dhe Promovimi i Dialogut Ndërkulturor | 7,692,200.00 | 22,429,600.00 | 22,429,600.00 | 22,429,600.00 | 74,981,000.00 |
| Kujdesi Shëndetësor | 569,800.00 | 3,255,400.00 | 3,255,400.00 | 3,255,400.00 | 10,336,000.00 |
| Punësimi e Formimi Profesional (AFP) | 2,538,200.00 | 13,443,200.00 | 8,804,800.00 | 8,919,800.00 | 33,706,000.00 |
| Strehimi dhe integrimi urban | 47,272,420.00 | 48,439,220.00 | 48,939,220.00 | 158,939,220.00 | 303,590,080.00 |
| Mbrojtja Sociale | 992,040.00 | 1,242,240.00 | 1,287,240.00 | 1,242,240.00 | 4,763,760.00 |
| TOTAL (1+2+3+4+5) | 66,537,980.00 | 96,381,380.00 | 91,875,780.00 | 201,798,180.00 | 456,593,320.00 |

Tabela 10 paraqet shpenzimet sipas burimeve të financimit dhe hendekun financiar për secilin nga objektivat specifikë. Shpenzimet për projektet e strehimit janë konsideruar pjesërisht si hendek financiar. Hendeku lidhet kryesisht me projektin për ndërtimin e banesave sociale. Ndërsa hendeku financiar për fushën e arsimit lidhet kryesisht me projektin për "Krijimi i infrastrukturës së përshtatshme në shkolla për të mundësuar zbatimin e sistemit pilot për mencat e shkollave që frekuentohen nga fëmijë romë dhe egjiptianë". Hendeku financiar i pambuluar nga të gjitha burimet e financimit është 33.5%. Një pjesë e hendekut financiar kërkon akordimin e fondeve nga bashkia dhe buxheti i shtetit, ndërsa pjesa tjetër mendohet të mbulohet nga donatorë të ndryshëm dhe organizata të shoqërisë civile.

*Tabela 10. Shpenzimet sipas burimeve të financimit*

| Përshkrimi | FINANCUAR NGA | | | | | Nevojat për |
|---|---|---|---|---|---|---|
| OBJEKTIVAT | Bashkia | Qeveria | Donatorët | Të tjerë | Totali | Fonde LEKË |
| Aksesi Barabartë në Regjistrimin Civil dhe në Drejtësi | 2,496,480.00 | 24,320,000.00 | 2,400,000.00 | 0.00 | 29,216,480.00 | 0.00 |
| Arsimi dhe Promovimi i Dialogut Ndërkulturor | 10,543,040.00 | 2,845,920.00 | 492,800.00 | 44,892,800.00 | 58,774,560.00 | 16,206,440.00 |
| Kujdesi Shëndetësor | 194,560.00 | 2,180,640.00 | 0.00 | 0.00 | 2,375,200.00 | 7,960,800.00 |
| Punësimi e Formimi Profesional (AFP) | 308,000.00 | 14,898,000.00 | 0.00 | 600,000.00 | 15,806,000.00 | 17,900,000.00 |
| Strehimi dhe integrimi urban | 174,790,080.00 | 18,800,000.00 | 0.00 | 0.00 | 193,590,080.00 | 110,000,000.00 |
| Mbrojtja Sociale | 2,618,760.00 | 300,000.00 | 0.00 | 1,045,000.00 | 3,963,760.00 | 800,000.00 |
| TOTAL (1+2+3+4+5) | 190,950,920.00 | 63,344,560.00 | 2,892,800.00 | 46,537,800.00 | 303,726,080.00 | 152,867,240.00 |

# IX. Monitorimi dhe Vlerësimi

Plani për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane në nivel vendor është një dokument politik dhe zhvillimi i Bashkisë për komunitetet e synuara dhe nuk duhet të përfundojë më miratimin e tij nga Kryetari dhe Këshilli Bashkiak. Monitorimi i rregullt i planit vendor për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në intervale të caktuara kohore, grumbullimi i të dhënave të treguesve të matshëm dhe vlerësimi i impaktit në përmirësimin e aksesit në shërbimet publike të ofruara për komunitetet dhe publikimi i rezultateve të zbatimit të masave është një përgjegjësi institucionale e bashkisë dhe që bazohet në parimet e besueshmërisë së qeverisjes vendore,  jodiskriminimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve dhe informimit publik.

Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit do të ushqejnë orientimin e politikave të reja dhe shpërndarjen e burimeve në nivel vendor në kuadër të planifikimit strategjik dhe procesit të vendimmarrjes vendore. Gjithashtu, raportet e monitorimit do të ofrojnë informacion të vlefshëm dhe cilësor në kuadër të raportimit të sistemit ROMALB, që kryhet dy herë në vit pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në nivel të lartë, raporti i monitorimit do të lehtësojë vendimmarrjen e informuar të grupit të lartë të menaxhimit të politikave në nivel vendor, i cili do të jetë përgjegjes për monitorimin e progresit të të gjitha planeve të zhvillimit të miratuara nga Bashkia, si Planin e Përgjithshëm Vendor,  procesin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe buxhetin vendor. Monitorimi i progresit të zbatimit të objektivave dhe masave/aktiviteteve të Planit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve të Bashkisë do të paraqitet në mënyrë periodike (të paktën 1 ose dy herë në vit).

Në nivel operacional, për monitorimin e zbatimit struktura përgjegjëse do të jetë Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar (DSHS). Kjo strukturë është përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave sasiore dhe cilësore  nga të gjitha strukturat e Bashkisë sipas sektorëve përkatës si dhe nga të gjitha institucionet e tjera publike. DSHC në Bashki ka rol koordinues dhe bashkërendues mbi ecurinë e zbatimit  të planit. Plani i Veprimit parashikon publikimin e progres raporteve vjetore dhe mbështetjen për raportet monitoruese të shoqërisë civile.

Sfida për një funksionim më të plotë të kuadrit monitorues mbetet rritja e kapaciteteve të vetë stafit të bashkisë, përmirësimi i shkallës së përgjegjshmërisë të strukturave të tjera të bashkisë si dhe bashkëpunimi dhe ndërveprimi me strukturat e tjera të nivelit vendor në varësi të institucioneve qendrore.

Procesi i vetë-deklarimit si romë ose egjiptianë nuk është i standardizuar dhe disa struktura në nivel vendor hezitojnë të mbledhin këto të dhëna nga frika se mos dhunojnë të drejtat e privatësisë dhe *të* drejt*ën* e vet*ë*-deklarimit, q*ë* sanksionohet me ligj. Nevojitet ngritja e kapaciteteve për të garantuar që të gjitha zyrat publike përkatëse të mund të mbledhin të dhënat e nevojshme për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit, duke mbrojtur njëkohësisht të drejtat e privatësisë së romëve dhe egjiptianëve. Mungojnë veçanërisht të dhënat mbi gjendjen e egjiptianëve[49].

Në nivel të sektorëve prioritarë dhe të objektivave strategjike, monitorimi do të kryhet përmes mekanizmit të vlerësimit bazuar në rezultate nëp**ë**rmjet treguesveve të matshëm, si dhe vëzhgimit mbi cilësin**ë** dhe aksesueshmërinë në shërbimet publike nga pakicat rome dhe egjiptiane. Këto vëzhgime vjetore duhet të ndërmerren nga bashkia në bashkëpunim me organizata komunitare dhe OSHC-të. Rezultatet e vëzhgimeve duhet të publikohen në faqen e internetit të Bashkisë dhe sistemin ROMALB.

Monitorimi i planit është një detyrë thelbësore, që duhet të plotësohet nga bashkia në mënyrë që cikli i kësaj politike në nivel vendor të plotësohet. Megjithatë, duke mbajtur në konsideratë kushtet e burimeve të kufizuara të stafit të bashkisë dhe kapaciteteve profesionale të kufizuara, monitorimi i planit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve mund të mbështetet edhe me ekspertizë të jashtme nga projekte të agjencive donatore. Kjo mund të vlejë veçanërisht në vitin e parë në procesin e realizimit të monitorimit. Ekspertiza e jashtme do të ndihmojë në zhvillimin *know-how* dhe përmirësimin e kapaciteteve të administratës vendore në drejtim të monitorimit dhe raportimit.

Bashkia përditëson rregullisht sistemin elektronik online "ROMALB" për regjistrimin dhe rifreskimin e të dhënave për treguesit e Planit të Veprimit NAPIRE, 2016-2020, dhe MSHPS ofron mbështetje teknike dhe trajnime për përdoruesit e sistemit në Bashki.

Baza kryesore e kuadrit monitorues të Planit për integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane në nivel vendor, do të jetë seti i treguesve të monitorimit.

Rekomandime për Bashkinë:

- Krijimi dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së Grupit Institucional të Punës përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin në nivel të lartë të zbatimit të planit të veprimit.

49 NAPIRE, 2016-2020

- Ngarkimi i nëpunësve vendorë përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin në nivel operacional të masave (p.sh. nëpunës nga Drejtoria e Shërbimit Social).
- Forcimi i bashkëpunimit me organizatat komunitare dhe OSHC-të (organizata vendore), që synojnë komunitetet rome dhe egjiptiane, si dhe me lehtësuesit ose pikat e kontaktit të romëve.
- Sigurimi i bashkëpunimit me projekte të financuara nga agjenci donatore për mbështetje dhe ekspertizë të jashtme.

# X. Shtojca

## X.1 Vlerësimi i Kapaciteteve të Bashkisë dhe Institucioneve të tjera në Nivel Vendor për Bashkinë Elbasan

Përkundrejt nevojave të identifikuara për komunitet rome, nevojitet të vlerësojmë edhe nivelin e kapaciteteve që bashkitë me të cilat po punojmë kanë në raport me secilën fushë interesi. Më poshtë paraqiten fushat e vlerësimit të kapaciteteve të bashkisë dhe pyetjet orientuese për secilin komponent. Të dhënat duhet të jenë të freskëta, në raport me 3 vitet e fundit. Përdorni kolonën e fundit të tabelës për shënime dhe detaje që plotësojnë dhe sqarojnë shifrat apo përgjigjet që keni dhënë në kolonën e dytë.

*Tabela 4. Vlerësimi i kapaciteteve të bashkisë në fushën e arsimit (përfshirë sistemin parashkollor)*

| | | | |
|---|---|---|---|
| **ARSIMI** | **A ka kryer bashkia ndonjë projekt përmirësimi infrastrukturor në 3 vitet e fundit?** | **Po/Jo** | |
| | *Nëse po, a ishte ndonjë prej tyre me numër të konsiderueshëm fëmijësh rom?* | Po/Jo | |
| | *Nëse po, a ishte kjo edhe me fonde të BE-së?* | Po/Jo | |
| | A ka kryer bashkia ndonjë trajnim për mësues në 3 vitet e fundit? (p.sh në bashkëpunim me DARin etj.) | Po/Jo | |
| | *Nëse po, a ishte kjo edhe me fonde të BE-së?* | Po/Jo | |
| | A ka ndërmjetësues shkollorë aktivë në komunitetet rome? | Jepni një shifër | |
| | A financon bashkia ndonjë program tjetër mbështetjeje për fëmijët rom? | Po/Jo | |
| | Cilët departamente/shërbime të bashkisë janë përgjegjëse/kompetente në këtë fushë? | Listojini ato | |
| | A mundet që çështje të lidhura me arsimin të adresohen në nivel vendor? | Po/Jo | |
| | A ka bashkia kapacitete për të hartuar dhe zbatuar projekte në fushën e arsimit? | Kapacitet i latë/ mesatar/i ulët | |
| | Cilat janë nevojat e bashkisë në këtë drejtim? (arsimin në përgjithësi dhe përfshirjen e fëmijëve rom në veçanti) | Specifiko | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Cili është fondi i investimit i miratuar për ndërtim të kopshteve të rinj dhe/ose rindërtim të kopshteve ekzistues në raport me buxhetin vendor për vitin e raportimit (në %) | _% | |
| | Referuar pyetjes me lart, a ka patur kopshte/ çerdhe, që frekuentohen nga femijë të komunitetit rom? | v.2019 (parashikimi në PBA) | |
| | Fondi i investimit vendor për ndërtimin e shkollave të reja dhe/ose rikonstruksionin e shkollave ekzistuese në raport me buxhetin vendor të miratuar në vitin e raportimit (në %) | __% | |
| | Referuar pyetjes më lart, a ka patur shkolla të mirëmbajtura/ose rindërtuara që frekuentohen nga një numër i konsiderueshëm fëmijësh të komunitetit rom? | | |
| | Çështje të tjera | | |

*Tabela 5. Vlerësimi i kapaciteteve të bashkisë në fushën e punësimit*

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **PUNËSIMI** | **A ka kryer bashkia ndonjë projekt që synon përmirësimin e aftësive dhe punësimin në 3 vitet e fundit?** | | **Po/Jo** | |
| | *Nese po:* | *A ishte kjo edhe me fonde të BE-së?* | Po/Jo | |
| | | *A kishte ndonjë fond nga donatorë?* | Po/Jo | |
| | | *Kush e zbatoi/po e zbaton projektin?* | | |
| | | *A kishte pjesëmarrje rome? Sa?* | Jepni një shifër (të përafërt) | |
| | Cilët departamente/shërbime të bashkisë janë përgjegjëse në këtë fushë? | | Listojini ato | |
| | A mundet që çështje të kësaj fushe të adresohen në nivel vendor? | | Po/Jo | |
| | A ka bashkia kapacitete për të hartuar dhe zbatuar projekte në pushën e punësimit? | | Kapacitet i latë/mesatar/i ulët | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | A ka mbështetur Bashkia të rinj rom për arsim dhe trajnim profesional në përputhje me nevojat e tregut të punës (në bashkëpunim me DARin dhe Zyrën e Punës)? Sa? | Po/Jo<br><br>Numër (të përafërt) | |
| | A ka të papunë R/E që marrin ndihmë ekonomike të cilët janë mbështetur financiarisht nga Bashkia për arsim dhe trajnim profesional? Sa? | Po/Jo<br><br>Numër (të përafërt) | |
| | Çështje të tjera me rëndësi për t'u shënuar? | Shëno | |

*Tabela 6. Vlerësimi i kapaciteteve të bashkisë në fushën e strehimit*

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **STREHIMI** | **A ka zbatuar bashkia ndonjë projekt në fushën e strehimit në 3 vitet e fundit?**<br><br>**A ishte ndonjë prej tyre i fokusuar për familjet/komunitetin rom?** | | **Po/Jo**<br>**Sa?_________**<br><br>**Po/Jo**<br>**Sa? _________** | |
| | *Nëse po:* | *A u aplikua për fonde?* | Po/Jo | |
| | | *A mori fonde nga BE?* | Po/Jo | |
| | | *Po nga donatorë* të tjerë? | Po/Jo | |
| | | *Kush e zbatoi/po e zbaton projektin?* | | |
| | | *A kishte pjesëmarrje rome? Sa?* | Jepni një shifër (të përafërt) | |
| | Cilët departamente/shërbime të bashkisë janë përgjegjëse në këtë fushë? | | Listojini ato | |
| | A mundet që çështje të kësaj fushe të adresohen në nivel vendor? | | Po/Jo | |
| | A ka bashkia kapacitete për të hartuar dhe zbatuar projekte në fushën e strehimit? | | Kapacitet i latë/mesatar/i ulët | |
| | Përqindja (%) e rasteve të strehimit social per komunitetin rom | | | |
| | Çështje të tjera me rëndësi për t'u shënuar? | | Shëno | |

*Tabela 7. Vlerësimi i kapaciteteve të bashkisë në fushën e kujdesit shëndetësor*

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **KUJDESI SHËNDETËSOR** | **A ka zbatuar bashkia ndonjë projekt për kujdesin shëndetësor në/për komunitetin ro në 3 vitet e fundit?** | | **Po/Jo** | |
| | *Nëse po:* | *A ishte kjo edhe me fonde të BE-së?* | Po/Jo | |
| | | *A kishte ndonjë fond nga donatorë?* | Po/Jo | |
| | | *Kush e zbatoi/po e zbaton projektin?* | | |
| | | *A kishte pjesëmarrje rome? Sa?* | Jepni një shifër (të përafërt) | |
| | Sa ndërmjetësues të kujdesit shëndetësor janë aktivë në komunitetet rome? | | Jepni një numër | |
| | Cilët departamente/shërbime të bashkisë janë përgjegjëse/kompetente në këtë fushë? | | Listojini ato | |
| | A mundet që çështje të kësaj fushe të adresohen në nivel vendor? | | Po/Jo | |
| | A ka bashkia kapacitete për të hartuar dhe zbatuar projekte në fushën e kujdesit shën-detësor? | | Kapacitet i latë/mesatar/i ulët | |

*Tabela 8. Vlerësimi i kapaciteteve të bashkisë në fushën e barazisë dhe përfshirjes sociale*

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **PËRFSHIRJA** | **A ka zbatar bashkia ndonjë projekt për promovimin e barazisë dhe përfshirjes sociale në 3 vitet e fundit?** | | **Po/Jo** | |
| | *Nëse po:* | *A ishte kjo edhe me fonde të BE-së?* | Po/Jo | |
| | | *A kishte ndonjë fond nga donatorë?* | Po/Jo | |
| | Cilët departamente/shërbime të bashkisë janë përgjegjëse/kompetente në këtë fushë? | | Listojini ato | |
| | A mundet që cështje të kësaj fushe të adresohen në nivel vendor? | | Po/Jo | |
| | A ka bashkia kapacitete për të hartuar dhe zbatuar projekte për përfshirjen sociale? | | Kapacitet i latë/mesatar/i ulët | |

Tabela e fundit prek një çështje ndërsektorale dhe ndërtematike, atë të financimit dhe ngritjes së fondeve për financimin e projekteve të ndryshme. Në këtë seksion në mënyrë specifike do të vlerësohen dhe jepen sa më shumë informacione dhe të dhëna mbi kapacitetet dhe mundësitë, që ka bashkia e synuar për shkrim projektesh, ngritje fondesh dhe zbatim të projekteve të financuar nga fonde të BE-së, fonde të donatorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë etj.

*Tabela 9. Vlerësimi i kapaciteteve të bashkisë në fushën e shkrimit të projekteve dhe ngritjes së fondeve*

| FINANCIMI | **A ka bashkia kapacitete të aplikojë dhe përdorë fonde të BE-së apo donatorëve të tjerë, përfshirë fonde kombëtare?** | **Kapacitet i latë/ mesatar/i ulët** | |
|---|---|---|---|
| | A mundet bashkia të aplikojë për fonde të donatorëve të tjerë (SDC/Zvicerane, EEA/Norvegjeze apo të tjera si rojekte Nderkufitare IPA, ADRION, MED, BALLKAN-MEDITERRAN)? | Po/Jo | |
| | Cilët departamente/shërbime të bashkisë janë përgjegjëse/kompetente në këtë fushë? | Listojini ato | |
| | A ka mbështetur Bashkia me grante OSHC që promovojnë integrimin social-ekonomik të komunitetit rom? | | |
| | Çështje të tjera me rëndësi për t'u shënuar? | Shëno | |

**Rritja e transparences në nivel vendor**

A kanë dhënë rekomandime pakicat rome dhe egjiptiane ose organizata e shoqërisë civile që mbështetin këto komunitete në procesin e konsultimit të buxhetit vjetor ose PBA? Nëse po, sa rekomandime janë reflektuar ne vitin 2018 ?

## Aspekte të tjera

| | Burime Njerëzore / Zhvillim të Kapaciteteve | Po | Jo | Shpjegime |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Nëse keni përshkrim pune, përcaktohen qartë roli dhe detyrat e gjithsecilit sipas pozicionit të punës? | | | |
| 2 | Ka sistem komunikimi efektiv lidhur me zgjidhjen e problemeve, kryerjen e detyrave/ funksioneve në Këshillin Bashkiak / ose titullarin e institucionit? | | | |
| 3 | Ka komunikime/ dhe pjesëmarrje të rregullta të pikave fokale për R&E në takimet e përbashkëta dhe të rregullta të Këshillit Bashkiak/ose në institucionet e tjera përgjegjëse për dhënien e shërbimeve publike për probleme specifike dhe që shqetësojnë komunitetin? | | | |
| 4 | Keni akses të mjaftueshëm në zhvillimin e aftësive (trajnime) për të kryer punën (shërbimin) me cilësi? | | | |
| 5 | Sa nëpunës janë trajnuar gjatë 2 viteve të fundit, jepni fushat kryesore. | | | |
| 6 | Keni aftësi të mjaftueshme për të kryer rolin tuaj në shërbimin publik te institucionit që i përkisni? | | | |
| 7 | Jepni deri tri drejtime në të cilat keni nevojë për rritje të aftësive në të ardhmen:<br>____________________<br>____________________<br>____________________ | | | |

## X.2 Grupi i Task Forcës Bashkiake në Elbasan

**Grupi Institucional i Punës, Elbasan**

| Emri | Mbiemri | Pozicioni |
|---|---|---|
| Gledian | Llatja | Kryetar / Bashkia Elbasan |
| Shefki | Lika | Drejtor i Kujdesit Social dhe Komunitar / Bashkia Elbasan |
| Ervin | Saraçi | Ish Nën Kryetar/ Bashkia Elbasan |
| Lindita | Senia | Përgjegjëse për Sektorin e Minoriteteve Rome dhe Egjiptiane / Bashkia Elbasan |
| Nadire | Kreka | Përgjegjëse Sektori për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Barazinë Gjinore / Bashkia Elbasan |
| Anila | Çota | Drejtoreshë / Zyra Arsimore Elbasan |
| Sonila | Banja | Specialiste e Sektorit të të Dhënave / Zyra Arsimore Elbasan |
| Mariol | Paralloj | Specialist / Drejtoria e Formimit Profesional Elbasan |
| Marsida | Hyseni | Drejtoreshë / Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Punësimit Elbasan |
| Alma | Braveshi | Nën drejtoreshë / Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Punësimit Elbasan |
| Behar | Tashi | Drejtor / Zyra e Gjëndjes Civile Elbasan |
| Danjela | Shuli | Kordinatore / Qendra Komunitare Rome |
| Albert | Hajrullai | Drejtor / Drejtoria e Territorit Urban / Bashkia Elbasan |
| Eltiona | Kolla | Përgjegjëse për shtresat në nevojë/ Bashkia Elbasan |

## Grupi Komunitar i Veprimit, Elbasan

| Emri | Mbiemri | Pozicioni |
| --- | --- | --- |
| Enver | Mustafaj | GKV |
| Denis | Demiri | GKV |
| Nikolino | Ademi | GKV |
| Mexhidije | Ademi | GKV |
| Brikena | Halimllari | GKV |
| Fiqirete | Ali | GKV |
| Ilir | Ademi | GKV |
| Blerina | Kallo | GKV |
| Sonila | Ademi | GKV |
| Shpresa | Demiri | GKV |
| Igli | Demiri | GKV |
| Ronaldo | Rakipi | GKV |
| Masimo | Ademi | GKV |
| Mimoza | Demiri | GKV |

## X.3 Vendimi i Këshillit Bashkiak Elbasan

601
30.04.2020

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN**

Nr. 1861/1 Prot

Elbasan më 30/04/ 2020.

**VENDIM**
Nr 43 datë 30/04/2020.

**Mbi miratimin e "Planit Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019-2022 të Bashkisë Elbasan".**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/04/2020 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga DSHKSK, bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 24, 28/1 dhe ligjin nr. 121/2016 datë 24.11.2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqërore" neni 36 ,

**VENDOSI**

1.Të miratojë "**Planin Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane 2019- 2022 të Bashkisë Elbasan**".

2 Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar, Drejtoria e Buxhetit si dhe Drejtoria e Financës.

1. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit nga Këshilli Bashkiak.

| | |
|---|---|
| Dr.Sh. K. Soc Komunit | Sh. Lika |
| Drejtori Juridik | O. Deliallisi |
| Drejtori Buxheti | M. Beluli, |
| Drejtori Financës | A. Merkja |

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**
**Klajd Gripshi**

**Kryetar i Këshillit Bashkiak**
**Hektor Çiftja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

# ROMACTED

*Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimit Rom në nivelin vendor*

SQI

Këshilli i Evropës është organizata udhëheqëse e kontinentit për të drejtat e njeriut. Përbëhet nga 47 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës e kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i projektuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

www.coe.int

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të bashkojnë njohuritë, burimet dhe fatet e tyre. Bashkarisht, kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qendrueshëm krahas ruajtjes së diversitetit kulturor, tolerancës dhe lirive individuale. Bashkimi Evropian angazhohet në ndarjen e arritjeve dhe vlerave me vendet dhe njerëzit përtej kufinjve të vet.

www.europa.eu

Financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës

EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet nga Këshilli i Evropës